



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Procesverbal i mbajtur më 29 prill 2021, në mbledhjen e XLVII (dyzet e shtatë) të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mandati i VI.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve në objekt të Komunës.

Mbledhjen e kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët/et e Kuvendit të Komunës, përveç z.Blerim Maçastena, i arrestuar, ndaluar dhe i paraburgosur në shtetin e Serbisë, (Lista e nënshkrimeve).

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishin edhe z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Podujevës, përfaqësues të OJQ – SDK, mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të LMT KFOR – Podujevë, si dhe një numër i qytetarëve dhe zyrtarëve komunal.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit duke iu dëshiruar punë të mbarë. Gjithashtu Kryesuesi kërkoj respektimin e masave anti Covid-19. Kuorumi për punë dhe vendimmarrje ekziston andaj ne mund të vazhdojmë me punë dhe vendimmarrje për këtë seancë, materialet gjithashtu i keni marrë me kohë, rendin e ditës, konstatimet dhe rekomandimet e KPF-së nga mbledhja e mbajtur më 27 prill 2021, nëse dikush ka diçka për të shtuar rreth rendit të ditës urdhëroni.

Rendi i ditës

z.Qëndrim Softolli, theksoi, para votimit të rendit të ditës kemi një letër prej kolegut mikut tonë z.Blerim Maçastena dhe desha ta lexoj, nëse me lejohet: *I respektuar Kryesueses i Kuvendit, të nderuar asamblistë, të nderuar të pranishëm, ju përshëndes për zemërsisht njëherit ju falënderoi nga zemra për mbështetjen morale dhe financiare që e keni bërë për mua. Më 6 janar 2021 më vizituan familjarët ndër të tjera më njoftuan që në Kuvendin Komunal sot nga ora 10:00 mbahet mbledhja e jashtëzakonshme për rastin tënd dhe jemi të thirrur si familje që të marrim pjesë, ndjenjë e pa përshkruar krenarie. Falë shokëve në fund të muajit mars i sigurova procesverbalet e mbledhjeve të Kuvendit Komunal (edhe pse ato kaluan 5 ditë në kontroll të Gjykatës), me kënaqësi i lexova fjalimet e secilit prej jush. I dëgjova përshëndetjet dhe urimet e juaja, e vërejta përkushtimin e pashoq të secilit prej jush. I ndjeva emocionet e fjalimeve të shokëve dhe shoqeve për shokun e tyre. E di që rasti im ka prekur ndjenjat e shumë qytetarëve anë e mbanë vendit, sidomos të atyre që i njoh dhe më njohin, jam ndjerë shumë keq në fillim po ndihem edhe tani ju kërkoj falje të gjithëve.*

Me dhjetëra mesazhe inkurajuese më vijmë çdo javë nga dashamirë të shumtë edhe pse jam larg vendit tim kurrë nuk jam i vetëm. Deri më tani autoritetet e burgut kanë qasje korrekte ndaj meje, me shëndet jam mirë, e di që këto dy gjera ju interesojnë më së shumti. Familjarët më vizitojnë rregullisht një herë në javë, gjithashtu ambasadori i Kosovës në Beograd z.Jetish Jashari më viziton rregullisht një herë në muaj, të dy palët më informojnë për zhvillimet në vend. Të dashur shok dhe shoqe, nga ju dua ndershmëri në punë, punë të mira për Komunën dhe përkushtim për vendin, ju dëshiroj shëndet e gjithë të mirat në jetë. Kurse shokut tuaj i mbetet me qëndrua ashtu si i ka hije, ashtu siç është edukuar nga familja dhe shoqëria.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, e falënderojmë këshilltarin z.Qendrim Softolli që e lexojë këtë letër të këshilltarit z.Blerim Maçastena, dhe në emër të Kuvendit i dëshirojmë shëndet dhe kthim sa më të shpejt aty ku e ka vendin.

z.Florent Hasani, theksoi, desha të shtoj diçka para fillimit të rendit të ditës pas këshillimit me grupet e këshilltarëve këtu në Kuvend pika e dalur nga KPF-ja, që është propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2020 në vitin 2021 dhe destinimi në kategori të caktuara buxhetore e renditur si pika 9 kërkojmë që të renditet si pika 2 pastaj rendi të vazhdoj ashtu siç është caktuar.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, para fillimit të rendit të ditës kam një propozim që të hedhet në votim, që Kuvendi Komunal të merr vendim për zhbllokimin dhe lirim të hapësirës publike dhe të autorizojë Drejtorinë e Inspeksionit që ta zhbllokojë procesin e fillimit të punimeve për obeliskun “Afrim Zhitia” në fshatin Llugë, që ka qenë një kërkesë e ka hershme dhe janë nda mjetet sa jam i njoftuar por nuk jam shumë i sigurt pasi Kryetari i Komunës nuk është këtu. Mjetet e parapara për këtë projekt pas këtij 6 mujori mund të humbin, kështu që ka qenë premtim dhe kërkesë e subjektit në pushtet që tani është LVV-ja, pastaj e kemi edhe një konstatim të ish drejtorit të DPKGJ-së, që prona aty është e uzurpuar, kështu që i nderuari Kryesues pavarësisht qëndrimeve të këshilltarëve pa ndërhyrë në asnjërin apo presion të votimit të lirë të hedhet ky propozim në votim, por në aspektin personal si asamblist edhe njëherë kërkojë nga Drejtoria e Inspeksionit që ta kryej detyrën e vetë sa i përket çështjes pronësore në atë vend.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, siç dëgjuat është kërkesë që të merren masa ligjore për lirim të Obeliskut “Afrim Zhitia” në fshatin Llugë që të vëhet në votim.

z.Haki Rudari, theksoi, kërkesa e kolegut z.Rafet Llapashtica lidhur me Obeliskun “Afrim Zhitia” ka qenë kërkesë edhe më herët, kjo kërkesë është shtyrë, është prolonguar me apo pa arsye po flas kështu për arsye se kam qenë pjesë e këtyre bisedave më herët, dua të them që më datë 27.10.2016 kemi qenë në një takim me ish Kryetarin, Nënkryetarin, ish Krye Shefin e grupit të LDK-së, ish drejtori i DPKGJ-së, ish Kryesuesi, dhe në atë takim është marrë vendim që pas proceseve gjyqësore që janë kjo çështje të implementohet, nga Ekzekutivi, të bësh kërkesë për dëshmorët mendoj që është nderë për të gjitha grupet e këshilltarëve e në këtë rast edhe për figurën e lartë kombëtare “Afrim Zhitia”, prandaj në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së e përkrahim këtë kërkesë dhe mendojmë që Ekzekutivi apo drejtoria do ta implementoj.

z.Hasan Ajeti, theksoi, askush nuk është kundër ndërtimit të Obeliskut që e përmendi kolegu paraprak mirëpo ajo që është me rëndësi njëherë, z.Rafet Llapashtica i bëri një kërkesë, Drejtorisë së Inspeksionit që t’i kryej punët që janë në kompetencë të saj, sa i përket Kuvendit unë nuk e besoj që është ndonjë delegat ose këshilltarë komunal këtu që e ngrit dorën kundër obeliskut së ikonës së kombit “Afrim Zhitia”, atëherë është kërkesë e imja që t’i përfundojnë punët organet Ekzekutive të Komunës, të jemi objektiv dhe real në këto pika sepse nuk duhet të kemi tendencë, unë mund të lexoj edhe politikë mirëpo ta përfundojnë punën njëherë organet Ekzekutive e pastaj vie në Kuvend

kjo kërkesë e që besoj se askush prej këshilltarëve komunal jo të LDK-së por asnjë grupi që janë këtu janë kundër.

z.Haki Rudari, theksoi, pajtohem në këtë pjesën e fundit me kolegun nga LDK-ja, z.Hasan Ajeti, që unanimisht të përkrahet kjo kërkesë nga të gjitha grupet e këshilltarëve për arsye se fillimisht duhet të merret kërkesa të implementohet ose të jepet vendimi i Kuvendi të Komunës e pastaj mbetet në kompetencën e Ekzekutivit, kërkesa e kolegut të dalë në votim dhe jam i bindur që të gjithë të pranishmit kemi me përkrahë, vërtetë sepse është një figurë e madhe e çështjes kombëtare, dhe njëherë po them është mirë që të vendoset në votim e pastaj mbetet detyrë e Ekzekutivit.

z.Hasan Ajeti, theksoi, ju z.Rudari vetë e thatë që kjo lëndë aktualisht është në procese gjyqësore, në çoftë se është jap vendimi pozitiv atëherë nuk ka nevojë fare këtu të kaloj sepse organet e administratës vetëm e bëjnë ekzekutimin e aktit por ndoshta ka ndikuar pak te ju agjërimi, por duhet disa gjëra t' i lexoni ashtu siç janë, në çoftë se kjo çështje ka kaluar në proces gjyqësore, organet administrative vetëm e zbatojnë vendimin, nuk kemi nevojë të bëjmë shfaqje këtu.

z.Haki Rudari, theksoi, i respektuar koleg nga LDK-ja pse jam agjërushëm është e vërtetë por megjithatë është mirë t'i kontrolloni dhe shikoni procesverbalet nga ish pushteti i kaluar pastaj të flasësh sepse nuk ke qenë prezent për atë kohë që unë po flasë andaj pyeti kolegët që kanë qenë në atë kohë, ne na mbetet që si Kuvend të mos bëjmë politikë, por mbetet të votohet ose mos të votohet ky propozim, pastaj pjesën që i takon Ekzekutivit le ta merr Ekzekutivi, këto procese kanë përfunduar dhe për ato procese Ekzekutivi mundet të bëjë njëjtë si Kuvendi ta kryejmë punën tonë dhe pastaj mbetet që organet tjera t'i shqyrtojnë procedurat, mandej është edhe ligji për dhënien e pronës publike në shfrytëzim i cili ligj në 6 mujorin e fundit nuk lejon dhënien në shfrytëzim.

z.Avni Islami, theksoi, pyetje për z.Rafet Llapashtica, a është marrë vendimi gjyqësor lidhur me këtë lëndë që u cek.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, po e shohë që po bëhen debate publike kur ne e dimë kronologjinë e situatës po flas për asamblistët që kanë qenë më herët e në qoftë se këtu dëshirojmë të gjirojmë filma e bëjmë por qëndrimi është individual, vota është sovranë e lirë pa ndërhyrje pro ,kundër, abstenim, unë e ngrita çështjen, statutin e pronës, ku dihet konstatimi i nxjerrë nga Ekzekutivi dhe qëndrimet e ish Kryetarit të Komunës, dhe qëndrimi i këtyre që janë tani në pushtet, të shohim edhe disponimin e asamblistëve, vendimin dhe qëndrimin tim personal të grupit tim edhe të mëhershëm tani kërkesa ime dihet, nuk dua të diskutoj se çka është bërë, sepse çka është bërë është kjo që deri sot jemi këtu, nuk dua as të etiketoj emra e as asgjë tjetër, kam kërkesë që kjo çështje të hedhet në votim, çështja tjetër nuk është detyrë e Gjykatës por detyrë e Drejtorisë së Inspeksionit që të lirojë pronën e uzurpuar, është kërkesë e imja kur të lirohet prona mjetet janë. Ekzekutivi ta bëjë sigurinë që operatori të kryejë punën e tij kaq asgjë më shumë, nuk merret Kuvendi me punët e Gjykatave, ne nuk jemi as Prokurori as Gjykatë çfarë bënë Gjykata ai është organ i ndarë ne duhet t'i kryejmë detyrat tona ata le t'i kryejnë detyrat e tyre në organet e gjyqësisë. Nuk e pengon asnjë vendim gjyqësor Drejtorinë e Inspeksionit të shkojë t'i largojë telat e vendosur dhe ta rregullojë procedurën e ndarjes së mezhdës. Inspeksioni së bashku me policinë të del tek vendi i ngjarjes kaq, e thërret operatorin e i thua eja fillojani punës dhe ta njoftoni uzurpatorin për fillimin e punimeve, nëse duam të kryejmë punë e nëse nuk duam bëjmë debate sa të doni, unë kërkojë të hedhet në votim propozimi pavarësisht qëndrimit të secilit.

z.Fatmir Gashi, Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, u shpjegua çështja e kësaj teme që ka qenë më parë e iniciuar e biseduar veç se së fundi ka marrë formë të cilën e potencoj edhe z.Haki Rudari që ka qenë pjesë e atij grupi, lënda ka shkuar në Gjykatë është pritur vendimi rreth pronës, tash vendimi rreth kësaj prone duhet shikuar se a ka marrë formë e prerë, nëse ka marrë formën e prerë ky

vendim atëherë të filloj zbatimin i tij nga ekzekutivi e që nuk ka nevojë fare të vihet në votim ky propozim.

z.Hasan Ajeti, theksoi, është shumë e thjeshtë në rast se ka vendim të lëshuar nga Gjykata, janë organet Ekzekutive që vetëm e zbatojnë atë vendim dhe kjo është punë e kryer.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, z.Hasan Ajeti pyetja ishte a ka pronë të uzurpuar aty. Ka konstatimi të Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, që ka pronë të uzurpuar, cili është obligimi i organeve tona, obligim i organeve tona është të lirojë pronën, dëgjo me mbajt etiketa publike për uzurpime e gjëra tjera nuk më interesojnë kushdo çofshin ata emra, se kush është uzurpator absolutisht fare i cilës do parti apo të qytetarëve, uzurpatori në pronë të dikujt tjetër nuk mundet të rrijë, është punë e drejtorit të DI të dal në vend të ngjarjes të lirojë pronën kaq. A fillojnë punimet a nuk fillojnë është çështje tjetër, ne tani me zor nuk e kryejmë punën, unë nuk dua të ndërhyjë nëse Kryesuesi e hedh në votim këtë propozim e ti ngrite dorën kundër sepse shumë transparent je, unë prapë edhe në seancën tjetër kam me kërkuar që Drejtoria e Inspeksionit me lirua atë pronë, kam kërkuar edhe në të kaluarën vazhdimisht, e kemi konstatimin e ish drejtonit të DPKGJ-së z.Llugaliu që prona është e uzurpuar, kemi kërkuar dhe kemi pasur qëndrim edhe të ish Kryetarit që me një marrëveshje të shikojmë se si të zhvillohet projekti, këndeje po shesim heroizma e në për përvjetorë po bëjmë thirrje për seanca dhe po vendosim lule a në anën tjetër po vërejmë diçka tjetër, unë nuk e kam asgjë as atë e as atë, por dëshiro ta kryej detyrën time si asamblist sipas mandatit deri në tetor, drejtoritë duhet ta kryejnë detyrën e tyre, drejtori i kaluar nuk e ka kryer detyrën e tij, për atë arsye e ka humb pushtetin, ka ardhur drejtori tjetër e që duhet ta përfundoj punën e tij, ne nuk po kërkojmë punë diçka jashtë kompetencës edhe ligjit as pse po thotë Rafeti po pse duhet ashtu ta përfundojë punën.

z.Hasan Ajeti, theksoi, Kuvendi nuk udhëzon nuk i jep rekomandime Ekzekutivit për punët të cilat ata duhet t'i kryejnë, Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit fatmirësisht është këtu e ka lëndën dhe mund ta vazhdoj procedurën, i kemi organet, kjo është absurde me mendua që Kuvendi me informua me tema Ekzekutivin, në këtë rast për shkak të pronës që është e uzurpuar, mbase lënda ka shkuar në Gjykatë, z.Rafet ju jeni jurist dhe këtu një shumicë janë juristë dhe e dinë që vetëm pritet marrja e vendimit nga Ekzekutivi i Komunës pastaj nuk e di pse me u fut në tema të popullzimit e idealizmit kur ajo është temë tjetër, për atë punë nuk e kam telashe jo një javë por një vit flasim por edhe për tema tjera ose për “çeiz”, për çka të duash ti flasim në këtë aspekt unë jam i hapur.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, z.Hasan Ajeti dëgjo se këtu nuse nuk ke me marrë me çeiz, dëgjo kolegun se çka po thotë se po më detyron të diskutoj jashtë temës, çështja në Gjykatë ka shkuar si shkak i mos kryerjes së punës së Ekzekutivit, unë nuk e di cila është detyra e një asamblisti këtu në Kuvend nëse nuk është detyrë e Ekzekutivit edhe e Kuvendit për lirim të pronës për zhvillim të projekteve për marrje të vendimeve unë nuk e di tani a duhet me hartua një hartim të përshtimit të detyrave tjera. Kërkoj falje për debatin z. Kryesues nuk ishte kjo çështje, të paktën dihet që ditën e përfundimit të zgjedhjeve janë marrë rrethojat me tel të pronës dhe janë vendosur hunjtë dhe është uzurpuar prona. Unë po e tregoj qëndrim timin personal nuk dua të etiketoj subjektet politike LDK-në ose LVV-në, vetëm se si asamblist po tregoj se po ta sillte një konstatim drejtori i DPKGJ-së i subjektin tim që prona është uzurpuar çdo seancë i kisha kërkuar ta lirojë pronën e ju nuk keni kërkuar këtë z.Hasan Ajeti. Ne kemi mbajtur takim siç e tha edhe z.Haki Rudari edhe me ish Kryetarin z.Agim Veliu edhe me shefa të grupeve, i dimë qëndrimet e secilit dhe shakatë që janë bërë vite më radhë me këto çështje, i dimë edhe popullizmat, ne e dimë kush ka shitë popullizma edhe kush është viktimizuar, ne jemi duke jetuar këtu unë nuk dua të ndërhyjë aspak në qëndrim të ndonjë asamblisti, dua ta hedhë në votim këtë propozim dhe unë votoj pro si Rafet si asamblist, kush të dojë le të votoj kundër ose pro, kaq. Tani me vendos kundër po ju dhemb, qysh kundër me vendos për jemi në kombinime atje e tani në të dyja anët nuk ju hyjnë në gjep, ti si asamblistë për

mos me diskutua thua Kryesues ngrite dorën bëjë atje çka të duash, unë nuk po them ju z.Hasan Ajeti, e dimë qëndrimin këtu që seanca është shtyrë rresht, 4 herë me radhë a ka pas disponim një qeverisje dhe një drejtor që ka qëndruar 20 vite aty se po ju vjen mërzi këtë që po ua them ju dhe këtyre po iu vije mërzi me krye punën e tyre, ish drejtori nuk ka mundur ta kryej punën ai nuk ka guxuar të shkoj në lokacion të pronës publike, unë kam qenë edhe me media edhe fizikisht dhe dal nga salla shkoj, unë nuk zmbrapsna siç mendon ti por nuk është detyrë e imja, unë me qenë drejtor them rri ti në seancë deri të përfundon seanca, ta liroj pronën e ai që kundërshton në pronë le të vije të më gjejë aty, po flas për veten time nuk dua të diskutoj as për ty e as për të tjerët por po tregoj qëndrimin tim personal, e unë e thashë atë që kisha për të thënë deri në përfundim të seancës se ky është qëndrimi im.

z.Bedri Maqastena, drejtor i DI, theksoi, meqë lënda ka shkuar në Gjykatë ne nuk mund të veprojmë derisa të marrë vendim Gjykata dhe nuk besoi që ka nevojë të hedhet në votim ky propozim, deri sa të vijë vendimi prej Gjykatës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, rregullorja e përcakton se një asamblistë, ka të drejtë ta hedhë në votim propozimin e tij, andaj drejtori të presë derisa Gjykata ta marr vendimin sepse nuk ka problem nëse mbetet propozimi im vetëm me një votë pro, unë kërkoj që propozimi të hedhet në votim, që të lirohet prona publike në Obilskun “Afrim Zhitia” dhe Ekzekutivi t’i krijoj kushtet për fillim të punës, kaq është tani dhe le të deklarohet secili. Drejtorit të Drejtorisë së Inspeksionit së pari i kërkoj falje se është seanca e tij e parë prej se e ka marrë detyrën dhe e njoftoj se ka me pas shumë punë si drejtori i DI dhe a e dini pse, se etiketimet për uzurpime 20 vite janë hedhë dikund tjetër e krejt dikush tjetër është uzurpatori për atë arsye nuk heq dorë në këtë drejtim, dua t’i shoh emrat e uzurpatorëve është seanca e 4-të ose e 5-të i nderuari Kryetar z.Bulliçi që kërkoj emrat e uzurpatorëve, drejtoresha e DPKGJ nuk qenka këtu se në mbledhje të Komitetit dhe në seancë të Kuvendit kam kërkuar listë zyrtare të pronave publike të uzurpuara në qytet, të pronave të dhëna me qira, le të vij në këto lista i nderuari Kryetar. Ekzekutivi i kaluar nuk e ka sjellë një listë të tillë me përjashtim të pronave në fshatra që për mua nuk personifikojnë ndonjë gjë shumë të rëndësishme për arsye se nuk krijohen shumë të hyra dhe interesi është shumë i vogël, e të njëjtin rrugëtim është duke e bërë edhe kjo qeverisje, në këta muaj që ka ardhur në krye të detyrës me votë, me ndryshim, me rrugëtim të njëjtë dhe nëse ato dy drejtori së bashku me Nënkryetaren dhe Kryetarin mos me qenë në gjendje që në këtë seancë të më ofrojë listën zyrtare të pronave me status të tyre se cilat janë dhënë për shfrytëzim me qira e cilat janë të uzurpuara është çështje tjetër ajo është në kompetencën tuaj, unë nuk e kam plan me dhunë me hy me trokit dyerve por po kërkoj zyrtarisht listën të cilën nuk e keni sjellë. Ky propozim duhet me u hedh në votim drejtor dhe ti në koordinim me drejtoreshën e DPKGJ-së me zyrtarët e kadastrit duhet të dilni në vend të ngjarjes ta merrni fletën poseduese t’i caktoni kufijtë e pronës, nëse këtë punë nuk mund ta përfundoni na merrni edhe ne që ta bëjmë rregullimin e mezhdës dhe ta lëmë ashtu pronën publike e nëse nuk mundeni ju ta kryeni punën atëherë duhet të vij një drejtor tjetër për me krye punën e tij.

z.Shpejtim Bulliçi, Kryetar i Komunës, theksoi, sigurisht jeni në njohuri që Komuna e Podujevës më datë 07.07.2007 ka nënshkruar një kontratë për shfrytëzim të paluajtshmërisë në pronësi të Komunës, Klubit të folklorit “Afrim Zhitia” nga Prishtina, një sipërfaqe prej 0.04 ha ku për këtë zonë kadastrale ekziston një kontratë legjitime, dhe në sajë të kësaj dhënie në shfrytëzim të kësaj prone publike është filluar procesi i ndërtimit të Obeliskut. Deri më sot ky Kuvend Komunal nuk ka nxjerrë asnjë vendim tjetër për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale në fjalë, sipërfaqe e cila është në dispozicion dhe për atë çdonjëri prej atyre që kanë pasur dhe kanë shprehur interes për të vepruar kanë mundur të veprojnë.

Kërkesa e më vonshme është bërë me një projekt ideor, përfshinë sipërfaqe mbi 293.669 m² për çka sa kam njohuri dhe informacione ky Kuvend Komunal nuk ka nxjerrë një vendim sot e asaj asaj dite. Sa i përket çështjes rreth proceseve gjyqësore, unë nuk e di sepse nuk kam informacione, por e gjitha çfarë di është fakti këtu që e kam para vetes sepse unë do flas me fakte, ka të bëjë me një aktvendim dhe është tentuar të bëhet kallëzim penal ndaj individëve të caktuar, atë vendim e ka hedhë si të pa bazuar Gjykata, dhe është vendim gjyqësor që e kam këtu, ky aktvendim është i datës 25.01.2016, po të kishte pasur diçka të tillë çfarë po pretendohet, me siguri kjo do të vazhdonte më tutje dhe nuk do të hudhej e pa bazë.

Unë po ashtu e kam edhe një kërkesë që ka ardhur ditën e fundit të mandatit të Ekzekutivit të kaluar, dokumentacion i cili është duke u trajtuar si problem nga ne si Ekzekutiv, prandaj mendoj që nuk kemi nevojë të ngutemi në këtë aspekt, të presim zhvillimin e procedurave dhe besoj që çdo gjë do të sqarohet me kohë. Është më se e vërtetë që ne nuk mund t'i dimë të gjitha gjërat që kanë ndodhur për këto 20 vite, ndoshta unë paksa këto gjëra i di por ka të tjerë këtu që janë të rinjë (prej gjitha subjektet politike) e mund të mos kenë njohuri, prandaj ju them që nuk ka nevojë të ngutet kjo çështje, absolutisht askush nuk është kundër Obeliskut "Afrim Zhitia" dhe besoj që këtu nuk kemi nevojë të kemi ndasi në aspektin politik dhe individual, por të gjithë jemi për të respektuar rendin, ligjin dhe rregullat që janë në dispozicion, e që janë 0.04 ha sipërfaqe që janë dhënë në dispozicion, ndërsa tani pretendohet për një sipërfaqe krejt tjetër që është me dhjetëra herë më e madhe për të cilën askush deri më sot nuk ka nxjerrë një vendim konkret rreth kësaj çështje, ndërsa si kanë shkuar procedurat më tutje nuk jam në dijeni sepse nuk kam qenë pjesë e organeve komunale deri më tani.

Sa i përket asaj që asamblisti z.Rafet Llapashtica e potencoi si çështje rreth pronave të uzurpuara, unë e di që informacioni që është dhënë nga drejtoresha se DPKGJ-së para disa seancave e cila ka treguar që të gjitha ato lista janë të gatshme dhe kushdo që është i interesuar mund t'i drejtohet zyrës së DPKGJ-së dhe mund t'i merr të gjitha ato informacione që mund t'ju interesojnë, qoftë për hapësirën urbane qoftë për atë rurale.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, atëherë ne kemi dy propozime, është propozimi i këshilltarit z.Rafet Llapashtica që kërkesa e tij të hedhet në votim, dhe është kërkesa e Ekzekutivit që të pritët deri të sqarohen gjërat definitivisht dhe pastaj të fillohet dhe të përfundohet ajo çështje që ka mbetur për një kohë. Unë jam i obliguar që t'i vejë në votim këto dy propozime para Kuvendit së pari është propozimi i këshilltarit z.Rafet Llapashtica.

z.Haki Rudari, theksoi, paraprakisht i nderuari Kryesues kam një kërkesë për një bashkëveprim dhe bashkëpunim me shefa të grupeve edhe me Kryetarin edhe njëherë para se të hedhet në votim ky propozim sepse po më duket që po dalim jo mirë edhe ne që po themi po edhe ata që janë kundër.

z.Hasan Ajeti, theksoi, kjo temë mori kohë, askush nuk është kundër duhet të lexohet drejtë, propozimin që z.Rafet Llapashtica e bëri sot realisht ka dy kuptime tani edhe Ekzekutivi nga spektri gjyqësor që ka pasur telashe dhe ka por nëse kërkon votën blanko të 13-15 delegate të LDK-së, për Obeliskun, të mos vazhdojmë më tutje me këtë temë, ta stopojmë atë qëndrimin prapaveprues që mbështetet pas kësaj kërkesë atë e keni të hapur tani hedhe në votim e ke votën mirëpo një gjë le ta sqaron nuk po hyjë në këtë punë të Ekzekutivit por po hyjë në punë të Kuvendit, sa i përket grupit të këshilltarëve të LDK-së për Obeliskun vetëm për emrin dhe mbiemri e heroit "Afrim Zhitia" e ke votën për.

z.Haki Rudari, theksoi, paraprakisht desha ta ngrisë këtë çështje me një konsensus për arsye se kështu ka qenë edhe më herët për të mos dalë asnjë grup kundër për arsye se deri më tani u thanë disa gjëra të tjera nga kolegu nga ana e LDK-së, tani është një pozitë tjetër edhe nga ana e tij, unë mendoj që është mirë shefat e grupeve së bashku me Kryetarin dhe drejtoreshën e DPKGJ të bisedojnë sepse për atë arsye kemi ardhur këtu, unë pajtohem vetëm që të dalim me konsensus nga

Kuvendi për arsye të fundit unë e kam votën time se si votoj do ta them në mënyrë të hapur por për të mos pasur probleme të tilla që LDK-ja, ishte për apo kundër, apo PDK-ja, ishte kundër kam dëshirë ta nxjerrim një konsensus rreth kësaj çështje andaj propozoj që të dalin shefat e grupeve bashkë me Kryetarin me një propozim.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, kërkoj që kjo seancë të zhvillohet komform pikave të rendit të ditës, mandej pas kësaj seance, kurdo që dëshironi me shefat e Grupeve të këshilltarëve bashkërisht edhe me drejtoreshën e DPKGJ-se ta organizoni një takim dhe ju pres të ulemi dhe të diskutojmë rreth kësaj çështje, dhe të përgatitemi për një seancë të radhës.

Besoj që kjo si propozim është e arsyeshëm pa pasur qëllim që tani ta vendosim në ndonjë pozitë të keqe ndonjë prej subjekteve politike këtu në Kuvend që pastaj dikush rreth kësaj çështje të dalë patriot e dikush jo. Pra jam i gatshëm t'ju pres në zyre shefat e Grupeve të këshilltarëve në mënyrë që bashkërisht të diskutojmë për çështjen e ngritur, mirëpo sot do të ishte mirë të mos humbim kohë më shumë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, kërkoj nga ju z.Kryesues edhe njëherë që pika e propozuar nga unë të hedhet në votim pavarësisht qëndrimeve politike. Pavarësisht kërkesës së Kryetarit që e ka qëndrimin e tij personal për atë çështje kemi mbajtur takime, unë edhe atëherë kam thënë ndryshimin kërkesa e juaja është e njëjtë sikurse e ish Kryetarit t'i thërrasim grupet parlamentare dhe Ekzekutivin e sipas kësaj ka mbetur deri këtu por nuk dua të vazhdojmë me të njëjtin problem.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, e mbyll debatin rreth propozimit të kësaj pike pasi që pikat e rendit të ditës duhet të jenë të shkurtra dhe konkrete andaj të hedhet ky propozim në votim meqenëse është temë e ndjeshme dhe jam i detyruar t'i hedh në votim dy propozimet. z.Rafet Llapashtica urdhëro saktëso edhe njëherë propozimin tuaj për shkak të procesverbalit që duhet ta evidentoj procesmbajtësi.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, propozimi im është marrja e masave dhe lirimi i hapësirës publike pranë Obeliskut "Afrim Zhitia", organizimi dhe krijimi i kushteve për rifillimin e projektit të objektit të paraparë për ndërtimin e Obeliskut nga organet kompetente të Ekzekutivit dhe të Kuvendit Komunal të Komunës së Podujevës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, atëherë e hedh në votim këtë propozim të propozuar nga këshilltari z.Rafet Llapashtica.

Njëzëri mbështetet propozim i z.Rafet Llapashtica që n'kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje, si pikë shtesë të hyjë edhe;

- *Marrja e masave për lirimin e pronave me qëllim të implementimit të projektit për ndërtimin e Obeliskut "Afrim Zhitia" në fshatin Llugë.*

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kjo pikë pra hynë si pikë e 10-të e rendit të ditës ku do të trajtohet, kemi edhe një pikë të rekomanduar nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më datë 27.04.2021 që iu ka rekomandua këtij Kuvendi e kjo pikë ka hyrë si pikë e 9-të e rendit të ditës që ishte kërkesë e shefit të Grupit të këshilltarëve të LVV-së, që të bëhet një rirenditje e ftoj ta specifikoj tani.

z.Florent Hasani, theksoi, kërkojmë që pika e rekomanduar nga KPF-ja që është Propozim vendimi për transferimin e mjeteve buxhetore nga kategoria rezervë-38 në kategorinë e shpenzimeve investime kapitale burimi financiar 10 e cila renditet në piken 9 të bartet si pika 2 e rendit të ditës.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, atëherë e hedh në votim rendin e ditës së bashku me dy pikat e propozuara nga ana e këshilltarëve për këtë rend dite.

Njëzëri miratohet rendi ditës së bashku me dy propozimet e këshilltarëve, përkatësisht, Në kuadër të rendit të ditës, në pikën 10, hyn edhe pika shtesë:

- ***Marrja e masave për lirimin e pronave me qëllim të implementimit të projektit për ndërtimin e obeliskut “Afrim Zhitia” në fshatin Llugë.***

Ndërsa,

- ***Propozim vendimi për transferimin e mjeteve buxhetore nga kategoria rezervë - 38 në kategorinë e shpenzimeve investime kapitale (burimi i financimit 10), e cila renditet në pikën 2 të rendit të ditës, ndërsa pikat tjera renditen sipas radhitjes.***

1. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2020 në vitin 2021 dhe destinimin në kategori të caktuara buxhetore

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF-së, theksoi, propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2020 në vitin 2021 është një obligim ligjor për bartjen e të hyrave vetanake të cilat nuk janë shpenzuar në vitin 2020 në projekte të cilat duhet të implementohen në vitin 2021, besoi që jeni të informuar të gjithë që Komuna e Podujevës e ka pasur një suficit buxhetor nga granit qeveritar, ato janë mjete të cilat nuk barten mirëpo të hyrat vetanake barten në vitin vijues, të hyrat vetanake të cilat nuk janë shpenzuar në vitin paraprak janë në vlerë 669,690,13.00€, për programin e Administratës Komunale ku përfshihet edhe planifikimi hapësinor dhe rregullativ për infrastrukturë publike, shërbimet kulturore janë 342,671,59.00€, në shëndetësi janë 28,466,61.00€ dhe në arsim janë 298,480,93.00€, ku listën e keni marrë me kohë po besoi para një jave dhe e keni çdonjëri para jush mos t’ju marrë kohë specifikacionin e listës së projekteve e keni se ku do të barten këto të hyra vetanake, sa për informim të gjitha këto projekte të cilat janë të specifikuara janë obligime kontraktuale për ne si ekzekutiv por edhe vendimi që duhet ta marrë asambleja komunale është ndër të tjera detyrim ligjor që të barten këto projekte për arsye se janë obligime kontraktuale dhe në rast se ne si asamble komunale dhe ekzekutiv kishim propozua ndonjë projekt tjetër Ministra e Financave nuk lejon me bartë në projekte të tjera për arsye se me mjetet financiare duhet me i mbulua obligimet kontraktuale të cilat i ka Komuna e Podujevës që janë të pa mbuluara.

z.Adnan Zymeri, theksoi, zakonisht kur në Kuvend kemi trajtuar tema që kanë të bëjnë me aspektin financiar siç janë rialokimet dhe ridestinimet për bartjen e mjeteve, ka qenë dhe është e rrugës që secila nga drejtorit të arsyetoj bartjen dhe të tregojë dinamiken e kontratës për projektet e specifikuara pavarësisht kësaj edhe para se të bëhet vlerësimi për propozim vendimin për bartjen e të hyrave, duhet t’ju tregojmë qytetareve se bartja e mjeteve është shuma e të hyrave vetanake të pa shpenzuara të vitit paraprak që kërkon të ridestinohet në projekte ndaj të cilave Komuna ka obligime financiare, vlerësimin për bartjen e këtyre mjeteve duhet ta bëjë në tri dimensione e para nga dimensionin profesional, bartja paraqet shumën e mjeteve të cilat destinohen në projekte të caktuara pa bërë tejkallime në kategorinë ekonomike si në rastin në fjalë tek mallrat dhe shërbimet në arsim në vlerë prej 230,000.00€, tejkallim nga rregullat kategorinë ekonomike të cilat në Ministri e Financave me një funksion normal nuk do ta pranoj nga ky dimension bartja duhet të bëhet kryesisht për të përmbushur obligimet financiare që Komuna ka ndaj operatorëve ekonomik, kryesisht pjesa

dërmuese për infrastrukturë e jo në projekte tjera të cilat nuk është nënshkruar ende kontrata, në aspektin politik bartja e të hyrave paraqet fuqinë e drejtorive për të ndarë mjete nga torta e ekzekutivit për dikasteret të cilat ata i udhëheqin si dhe fuqive të cilat do të garojnë brenda subjektit politik për asamble komunale në këtë vit zgjedhor dhe nga shumat që do të barten shihet që me të drejtë prioritet ka drejtoria e arsimit gjë për të cilën me vije shumë mirë ngase udhëhiqet nga një njeri prej pak njerëzve me eksperiencë të këtij Ekzekutivi por fatkeqësisht këtu nuk shihet bujqësia që është shtyllë e zhvillimit ekonomik lokal me përqindje shumë të vogël si dhe shëndetësia e cila ka vëmendje shumë të vogël në këtë kohë pandemie. Ndërsa sa i përket konsistencës së qëndrimeve politike gjë për të cilën LVV-ja njihet shumë mirë vetëm analizohen nga procesverbali fjalën e përfaqësuesve të opozitës së atëhershme lidhur me bartjen e mjeteve të herës se fundit të propozuar nga Ekzekutivi i kaluar natyrisht fjalët më toksike të diskursit politik ndërsa krejt çfarë ka ndryshuar nga atëherë deri më tani janë pozicionet politike as nuk ka ndryshuar forma e bartjes as transparenca nuk është më e lartë është komplet i njëjti dokument vetëm me shifra të tjera krejt në fund LDK-ja është për furnizim me kabinete të reja për shkolla është për fusha të hapura sportive dhe për projekte të tjera që ndikojmë pozitivisht tek qytetaret tonë por gjithmonë duke përfillur rregullat e përcaktuara financiare për kategoritë e caktuara ekonomike.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, në grupi i këshilltarëve të LVV-së e mbështesim bartjen dhe ridestinin e mjeteve të cilat bëhen në bazë të kornizave ligjore, bartja e të hyrave nga viti 2020 në vitin 2021 është shumë e nevojshme për vazhdimin dhe përfundimin e projekteve të cilat nuk kanë mundur të realizohen edhe pse shpresojmë që viteve të tjera të kemi bartjen më të vogël pra planifikimet t'i bëjnë më të përafërta me buxhetin rreth rialokimit.

z.Fatmir Rudari, theksoi, pas sqarimeve të drejtorit të DBF-së që këto projekte janë të mbetura në gjysmë dhe duhet të plotësohen këtë vit grupi i këshilltarëve të PDK-së e përkrahë këtë ridestinin të mjeteve.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nëse nuk ka dikush çfarë të shtojë për këtë pikë të rendit të ditës atëherë e hedh në votim.

Me 18 vota për, asnjë kundër dhe 14 të përmbajtura miratohet Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2020 në vitin 2021 dhe destinimin në kategori të caktuara buxhetore.

2. Propozim vendimi për transferimin e mjeteve buxhetore nga kategoria rezervë - 38 në kategorinë e shpenzimeve investime kapitale (burimi i financimit 10)

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF-së, theksoi, buxheti i vitit 2021 i cili është miratuar nga kjo asamble komunale nga 4 projekte të cilat e miratuan atë buxhet siç ka qenë projekti për meremetimin e hyrjeve banesore me vlerë prej 80,000.00€, ndërtimi i shtëpisë së shëndetit Podujeva III në vlerë 100,930,000€, ndërtimi i shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve në vlerë prej 100,000.00€ dhe një projekt për drunjtë dekorativ në vlerë 100,000.00€ të gjitha këto 4 projekte janë në vlerë 380,930.00€, nga Ministria e Financave janë vendosur në kategorinë rezervë për arsye të ndryshme çoftë për shkak të keq klasifikimeve buxhetore çoftë për shkak mos plotësimit të duhur në investime publike që bëhet nga zyrtarët, drejtoria e zhvillimit ekonomik për sqarimin edhe të disa çështjeve teknike janë hedhur në kategorinë rezervë tani është obligim ligjor që prapë t'i kthehemi asamblesë komunale në mënyrë që këto mjete nga kategoria rezervë të barten në projektet kapitale, këto mjete janë hedhur në

kategorinë rezervë për arsye të ndryshme dhe tani të gjitha këto aktivizohen në këto 4 projekte të cilat i kemi paraqitur për bartje përjashtimisht të drunjtëve dekorativ. Projekti për drunjtë dekorativ është një projekt që ka kaluar procedurat e prokurimit dhe do të implementohet mirëpo ai projekt që është votuar si investim kapital, rrjedhimisht nuk është investim kapital por është mall dhe shërbim dhe do të paguhet nga kategoria mallra dhe shërbime dhe nga këto 100,000.00€ si investim kapital është propozuar ndërtimi i objektit të çerdhes në qytet afër shkollës “Fan Noli” që faktikisht është vazhdim i ndërtimit të asaj çerdheje pra bëhet fjalë për projektet të njëjta të cilat janë votuar në buxhetin e vitit 2021 përjashtimisht të këtij projekti duke mos me u anashkaluar projekti paraprak që ka qenë për drunjtë dekorativ ai është vetëm në fazën e nënshkrimit të kontratës vetëm do të paguhet nga kategoria mallra dhe shërbime.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, atëherë sa për sqarim kjo pikë ka ardhur në mbledhjen e KPF-së dhe ne grupi i këshilltarëve të LDK-së kemi qenë të përmbajtur në këtë pikë me arsyen e vetme që është sjellë me vonesë dhe duke pasur parasysh faktin që në të kaluarën sa ju ishit në opozitë keni qenë shumë kritik për shkak të sjelljes me vonesë të pikave të tilla në kuadër të rendit të ditës por përtej kësaj në parim ne si grup i këshilltarëve të LDK-së jemi përkrahës të çdo vendimi i cili sjellë investime dhe punë të mira për qytetaret e këtij vendi përveç kësaj desha të shtoj edhe një element tjetër që transferime të tilla buxhetore kanë ndodhur edhe në të kaluarën ta zëmë nëse e marrim një transferim që ka ndodhur në shtator të vitit të kaluar aty specifikohet qartë jo vetëm se ku shkojnë dhe nëpër cilat nënkategori shkojnë këto mjete por edhe nga janë marrë këto mjete, drejtori i DBF-së i përmendi disa në terma të përgjithshëm për ne, por unë po flasë për dokumentin të cilin e keni përpara si dokument zyrtar që ka hyrë në rend dite prapë edhe këtë e përmenda me të vetmen arsye që edhe këtu keni qenë gjithmonë ithtarë të specifikimeve dhe konkretizimeve prandaj vetëm ta keni parasysh këtë për herët tjera, ato që i keni kritikuar t’i përmirësoni në të ardhmen.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, pas sqarimeve të drejtorit të DBF-së ne grupi i këshilltarëve të LVV-së e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës.

z.Bashkim Sylja, theksoi, në bazë të sqarimeve që i bëri drejtori i DBF-së edhe ne si grup jemi për miratimin e kësaj shume të mjeteve.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, nëse ka dikush diçka të shtoj rreth kësaj pike të rendit të ditës ju ftoj ta merrni fjalën, nëse jo e vë në votim.

Me 13 vota për, asnjë kundër dhe 13 të përmbajtura miratohet Propozim vendimi për transferimin e mjeteve buxhetore nga kategoria rezervë - 38 në kategorinë e shpenzimeve investime kapitale (burimi i financimit 10)

3. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – mars 2021

z.Fatlum Osmani, drejtor DBF, theksoi, raporti financiar për periudhën janar-mars 2021, i pasqyron aktivitetet dhe shpenzimet që janë bërë gjatë kësaj periudhe nga ana e Komunës së Podujevës, qëllimi i këtij raporti është që të prezantohet pasqyra e aktiviteteve buxhetore edhe njëherë në çoftë se e marrim shumën totale të buxhetit fillestar të cilit është aprovuar në vitin 2021 është sipas kësaj strukture të paraqitur si në vijim: në paga dhe mëditje 12,550,000.00€, në mallra dhe shërbime 2,533,578.00€, shpenzime komunale 420,000.00€, subvencione 720,000.00€ dhe shpenzime kapitale 7,600,26.00€. Gjatë gjithë kësaj periudhe janar-mars 2021 progresi i shpenzimeve është arritur në

shumën 3,359,651.00€ dhe atë në paga dhe mëditje janë shpenzuar 3,218,125.00€, në mallra dhe shërbime 222,199.00€ në shërbime komunale 61,461.00€ në subvencione dhe transfere 90,323.00€ dhe në investime kapitale 267,540,43.00€, sigurisht ndoshta edhe në KPF fillimisht është zhvilluar njëfarë diskutimi për shumen e vogël të shpenzimeve për të gjitha kategoritë përjashtimisht të kategorisë së pagave mirëpo diçka është e ditur se gjatë periudhës janar-mars mundësit për investime për shkak të klimës dhe shkaqeve tjera atmosferike punimet janë të vogla dhe rrjedhimisht edhe shpenzimet janë më të vogla mirëpo njëkohësisht kjo periudhë është edhe periudha e prokurimit të projekteve, tani edhe aty kanë filluar investimet, tani është një dinamikë krejt tjetër dhe deri në fund të qershorit do të përmbushet kuota e shpenzimit afër 50 % të investimit të planifikuar nga ana e Komunës së Podujevës kur dihet që me plane të prokurimit është duke ecur jashtëzakonisht mirë dhe ndoshta mbi 70 % të projekteve janë dërguar në prokurim. Sa i përket inkasimit të hyrave vetanake për periudhën janar-mars janë inkasuar 378,879.00€, shumën më të madhe të këtyre mjeteve janë inkasuar nga kategoria e tatimit në pronë në vlerë 206,405.00€, besoi që e keni vërejtur të gjithë ju që në fund të raportit financiar është tabela e shpenzimeve e marrë nga “free balance” ku çdo faturë e shpenzuar në Komunën e Podujevës paraqitet aty dhe këtë praktikë për hir të transparencës do ta vazhdojmë edhe në raportet e tjera financiare.

z.Mehmet Gashi, theksoi, unë nuk do të lëshohem shumë rreth raportit financiar për periudhën janar-mars 2021, mirëpo i kam vërejtur disa karakteristika me qëllim që të keni parasysh shpenzimin e buxhetit ashtu siç është dinamika e paraparë, drejtori i DBF-së e dha një arsyetim si informatë, nuk kam vërejtje mirëpo kisha për t'i cekur disa shpenzime të buxhetit për këtë periudhë meqenëse është periudhë 3 mujore atëherë në bazë të rregullave duhet të jetë shpenzuar, 1 kuota e buxhetit apo 25 % e buxhetit, ashtu siç e ceku drejtori i DBF-së te investimet kapitale është e pa mundur në këtë periudhë të bëhet zhvillimi i punimeve për shkak të procedurave të prokurimit dhe zhvillimit të punimeve mirëpo ka pasur edhe projekte 2 vjeçare që kanë mundur të realizohen pak më shumë sesa 3.6% të shpenzimeve të buxhetit për këtë periudhë në total vërehet se për qëllimin 25 % të buxhetit janë shpenzuar, 16.2% e buxhetit, tek pagat vërehet që kemi një tejkalim për 80,625.00€, është shpenzuar më shumë se që kemi buxhet në këtë periudhë dhe nëse shkojmë me këtë trend brenda dite mund të shkojmë deri te 2,000.00€ nuk e di a është ndonjë gabim apo është tejkaluar buxheti më shumë. Si ekonomist menaxheri i mirë i buxhetit duhet të ketë qëllimet që prej buxhetit mos të mbes suficit por mos të ketë deficit domethënë tejkalim të buxhetit unë ju kam bërë edhe vërejtje në KPF edhe sa ka qenë qeverisja e LDK-së, e për dinamik në muajt e parë të ulët të buxhetit ndoshta kam pasur edhe vërejtje por në fund ka ndodhur që 2 milion kanë shkuar suficit kështu që për të mos ardhur deri tek suficiti është mirë të rritet dinamika e shpenzimeve, tek mallrat kemi vetëm 8.8 % të buxhetit të shpenzuar, shpenzimet komunale, 14.6 %, subvencionet i kemi 12 % tek investimet kapitale e thash shumë e ulët vetëm 3.5 %, sa i përket të hyrave vetanake shihet që është një ngritje në krahasim me periudhën e kaluar. Komuna e Podujevës për nga të hyrat vetanake bënë pjesë në komunat më të vogla të Kosovës, është mirë që edhe përkundër fakti që nuk kanë qenë ditët e fundit të hyrat aq të larta me i shtuar të hyrat vetanake për shkak të zhvillimit të projektit, tek të hyrat kam vërejtur lejet e ndërtimit nga 170,000.00€ sa janë paraparë në buxhet për këtë vit vetëm 50€, janë realizuar, është vlerë e ulët as 1 %, nuk janë realizuar të hyrat vetanake kjo është si vërejtje që në të ardhmen të bëhet një përmirësim më tepër s'kam çfarë të shtoj meqenëse raporti mundet edhe mos të votohet mirëpo shpesh herë duhet këto përqindje t'i keni parasysh.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, ne grupi i këshilltarëve të LVV-së e kemi analizuar raportin financiar për tre mujorin e parë të vitit 2021 rreth 18% e buxhetit është shpenzuar në 3 mujorin e parë, 3% e buxhetit është shpenzuar në projekte kapitale, 12% e buxhetit është shpenzuar në subvencione dhe transfere, 14% e buxhetit është shpenzuar në shërbime komunale, 8% e buxhetit

është shpenzuar në mallra dhe shërbime, 25% e buxhetit është shpenzuar në paga dhe mëditje. Është për tu përshëndeture raporti i analizave të llogarive të nxjerra nga “free balance” mirëpo ende duhet të punohet për një formë më të lehtë dhe më të qartë për raportet financiare, meqenëse kemi të bëjmë direkt me informimin e qytetarëve rreth shpenzimit të parasë publike. Sa i përket investimeve kapitale që kemi një shumë të vogël të shpenzimeve, mirëpo kemi mirëkuptimin për shkak se kemi shumë projekte të paraqitura te prokurimi e që mund t’i shihni në faqen publike të Komunës. Falënderojmë drejtorin që ka filluar të na sjellë raportin dhe që sqarohen shumë mirë shpenzimet në bazë të performancës komunale për këta 3 muaj.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, në bazë të paraqitjeve të raportit 3 muajor që e ka bërë drejtori i DBF-së, për mjetet e parapara për vitin 2021, ashtu si në të kaluarën edhe në këtë qeverisje e shohim një dinamikë të ulët të projekteve rreth realizimit të tyre dhe të zhvillimit komunal nga 7,626,000.00€, vetëm 267,000.00€ deri më tani janë shfrytëzuar dhe në bazë të kësaj dinamike si në të kaluarën do të shohim se do të ketë suficit buxhetor, ku gjendja në Kuvendin Komunal nuk është e mirë sa i përket infrastrukturës, ambientit, shëndetësisë dhe kërkesave të qytetarëve.

Sa i përket bartjes buxhetore prej 666,000.00€ për këtë vit dhe mbi 2,500,000.00€ suficit po i bie që Komuna e Podujevës ka neglizhuar në vitin 2020, me 3,000,000.00€, për arsye të mos aftësisë së zyrtarëve kompetent të drejtorive përkatëse. Në bazë të raportit që e potencoj kolegu më herët kam vërejt një dinamikë që është pagesa mbi 8%, për paga andaj për drejtorin e DBF-së kam një pyetje konkrete se si ka mundësi të bëhet ekzekutimi i pagave më shumë se sa që është numri i punëtorëve. Si janë bërë këto pagesa mbi 8%, prej listës së pagave më shumë se sa numri i punëtorëve. Ne si grup i këshilltarëve të PDK-së, kemi bërë një kërkesë që të shikohen mundësitë buxhetore që të subvencionohen personat e infektuar me virusin COvid-19 dhe ato familje që kanë humbur familjarët e tyre nga ky virus pasi që nga buxheti po mbesin mjetet suficit. Në këtë raport unë kam vërejtur që Hilmie Hodolli është subvencionuar me 589,92.00€, për rast vdekje të anëtarit të familjes, 379,66.00€, Agim Idrizi është subvencionuar për rast vdekje të anëtarit të familjes, Skender Maloku gjithashtu është subvencionuar me 505,91.00€, për rast vdekje të anëtarit të familjes, prapë Hilmie Hodolli është subvencionuar për rast të vdekjes së anëtarit të familjes me 589,92.00€. Nuk po lëshohem më tutje me emra i nderuari Kryetar i Komunës dhe ju drejtor i DBF-së, këto pagesa a janë bërë për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike apo se një ceremoni e varrimit kushton më shumë se sa një tjetër ceremoni apo një Hoxhë i kryen ceremonitë e varrimit me çmime të ndryshme, kur dihet se Kuvendi i Komunës i mbulon shpenzimet e shërbimeve të varrimit me Bashkësinë Islame në Podujevë, cili është qëndrimi yt personal që për dikë lëshon pagesa prej 593,2.00€ e për dikë 308,5.00€, për me i krye këto shpenzime e për dikë asgjë hiç. Me qeverisë dhe me marrë përgjegjësi duhet me qenë i vendosur sepse duhet me ditë me thënë po dhe jo dhe duhet me ditë me ia hap derën atij që e meriton dhe me e fut brenda dhe me largua jashtë derës atë që se meriton këto ishin pyetje konkrete. Subvencionin në shumë prej 9,360.00€ për Bashkësinë Islame që kërkesat e tyre i kemi mbështet dhe i mbështesim në vazhdimësi për ceremonitë e varrimeve, ndoshta ky është ndonjë subvencion për ndërtimin e ndonjë Xhamie apo objekti tjetër fetar andaj ne duam një sqarim se për çka janë lëshuar këto mjete. Janë rrit shpenzimet e telefonisë, në një rast e arsyetova për shkak të komunikimit verbal si shkak i pandemisë por nuk e arsyetova rritjen e derivateve kur puna është zhvilluar me staf esencial. Të nderuar ju Kryetar dhe drejtor i DBF-së ju falënderoj për transparencë por duhet me pas kujdes kur paraqitet dokumenti dhe me i përgatit përgjigjet sepse ju dhe disa koleg këtu po deklaroheni pse po debatohet këtu sepse kur debatohet rreth një çështje dikush është gabim sepse të dyja palët nuk mund ta kenë të njëjtën çështje mirë dhe unë në këtë rast them se ju Kryetar jeni në pozitë të keqe sepse e ke vazhduar rrugëtimin e njëjtë e sidomos më keq sepse ke vazhduar me tjetër kënd. Po them se jeni duke qeverisur keq sepse ne kemi kërkuar që të subvencionohen

rastet e vdekjes nga virusi Covid - 19, dhe s'keni ditë çka të bëni por dikujt i keni nda mjete ashtu siç keni pas qejf ju ja keni nda 500.00€, dikujt veç pse e don ti ose je më i dhimbshëm se të gjithë të tjerët këtu. Keni rritur shpenzimet telefonike njëkohësisht me ato të derivateve dhe automjetet po bëjnë aksidente para shtëpisë suaj në fshatin Llugë, sepse s'je në gjendje me ju thënë lëreni veturën zyrtare këtu. Për me shëtitë dhe me thënë se e kam mirë nuk mundesh me thënë, ti je kompetent për t'i caktuar zyrtarët që personat zyrtar t'i dërgojnë në shtëpi dhe veturat zyrtare t'i kthejnë në auto parking njësoi si shoferi juaj. Nuk mundesh me i rritë shpenzimet e telefonisë mobile në 1800.00€ e diskrepancën 20-30%, në gjendje pandemie dhe me i rritë shpenzimet e derivateve e me mungua vizitat në terren e me shëtitë te liqeni i Batllavës. Unë i bëra disa pyetje direkte për drejtorin e DBF-së dhe shpresojmë në përgjigjet e tij sepse aty ku propozimet janë mirë ne i mbështesim dhe i votojmë por aty kur është keq jo, por edhe me ju z.Kryetar, e vazhdojmë debatin deri në fund por ju do të dilni edhe më keq.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, i nderuari asamblist (i drejtohet parafolësit z.Rafet Llapashtica), ju sqaroj se këto subvencione janë ndarë në bazë të procedurës ligjore sipas të cilës, në rast të vdekjes së anëtarit/es së familjes së ngushtë i takon të punësuarit të shpërblehet me një pagë mesatare që e ka. Ekziston baza ligjore dhe ju lutem shikoni bazën ligjore merrni informacione dhe besoj se do ta keni të qartë pse janë ndarë këto mjete buxhetore në këtë formë, mandej mund edhe të konsultoheni edhe me zyrën ligjore për këtë çështje.

Sa i përket makinës së aksidentuar, ju njoftoj se makina ka qenë me personel shëndetësor dhe me vozitës zyrtar, aksidentet mund të na ndodhin të gjithë neve.

Sa i përket shpenzimeve telefonike, nuk ka mundësi në asnjë formë të ketë rritje të shpenzimeve, ne kemi zvogëlim të derivateve dhe të shpenzimeve telefonike dhe shpenzime të reputacioneve tjera të cilat janë të determinuara dhe të faturuara.

z.Hasan Ajeti, theksoi, sot në prezencën tonë u prezantua raporti financiar për periudhën janar – mars 2021, është e kuptueshme që nga ekzekutivi dhe këshilltarët e LVV-së ky raport lexohet si dokument që paraqet transparencë, llogaridhënie dhe menaxhim objektiv të financave publike. Ajo çka e karakterizon këtë raport për habi është rritja në kategorinë e shpenzimeve në disa kode buxhetore ku deri dje sa ishte opozitë LVV-ja, parafolësja kolege znj.Doruntina Hasani ka pasur vërejtje goxha të mëdha si në cilësime që besa këto kode i ka lexuar si luks të shpenzimeve. Tani ka ndërruar raporti dhe qëndrimi i saj kuptohet e lexoj drejtë është i ndryshëm. Ka shkuar në akuza sa që thoshte se edhe qyteti është i pa pastër pasi që në vitin 2020 për këtë periudhë të njëjtë kohore ishin shpenzuar 5275.00€, e sot në vitin 2021, janë shpenzuar 7,222.00€, të gjithë ne që jetojmë në Podujevë e dimë se si është gjendja aktual e pastërtisë në qytet, shërbimeve publike e deri te orët e rrymës që kanë qenë premtim i ish drejtorit z.Ajet Potera, por fatkeqësisht me ikjen e tij ky premtim kolosal do të mbetet vetëm në letër. Sot kur bëjmë krahasim tabelar nuk do të thotë të jesh ekonomist sepse nuk jam ekonomist por në mes të viteve 2020-2021, e lexon pastër se ekzekutivi i LVV-së i ka ulur shpenzimet në kategoritë që do t'i lexojë por këto shpenzime janë rritur duke u nisur nga kodi 13/250 që janë shpenzimet telefonike që janë 1216.00€, e në kohën e qeverisjes së LDK-së këto shpenzime kanë qenë 871.00€, furnizim ushqim dhe pije sot e nderuara znj.Doruntinë i ke 3472.00€, e në kohën e qeverisjes së LDK-së këto shpenzime kanë qenë 1842.00€, furnizim për zyre sot janë shpenzime 13,925.00€, në kohën e qeverisjes së LDK-së këto shpenzime kanë qenë afër 10,000.00€, karburant për vetura janë shpenzuar mjetet buxhetore në shumë 19,000.00€, sa kanë qenë 13,000.00€, naftë për ngrohje sot në këtë raport janë cekur 8,518.00€ shpenzime kurse në qeverisjen e LDK-së, kanë qenë 1,874.00€, furnizim me pastrim 4,306.00€ janë sot kurse kanë qenë 1,100.00€, drekat zyrtare janë rritur 100%, 613.00€, gjithashtu shto këtu edhe shpenzimet e fundit që janë bërë për blerjen e uniformave për zyrtarët e drejtorisë së Inspeksionit e që nuk janë pjesë e këtij

raporti. Marrë për bazë standardin e jetës shifrat lexohen se trendi i çmimeve ka avancuar me ardhjen e juaj në pushtet, po ashtu procedura e tendero manisë që deri dje po nga këta që sot janë ulur në ekzekutiv pa reshtur kanë nxjerrë konstatime se këtu ka pazare dhe deri në atë masë sa që keni bërë kallëzime penale por tani situata nuk po e thotë atë. Nuk e përmendni askund që me një tender sa i përket blerjes së uniformave ku një palë këpucë kanë shkuar në vlerë prej 50.00€ që është një standard goxha i madh e duke i hedhur telashet në fushën e shëndetësisë për rastet e personave të prekur me virusin Covid-19 që prezent e kemi drejtorin e që po më duket se është lodhur pak sepse ka menduar se e ka pakë më lehtë punën mirëpo ajo thënia e të moshuarve, kur thonë mos hy në mal pa sëpatë se nuk mund të dalësh dhe po doket se edhe ky nuk po mund të dal. Të gjitha këto që i thash mbeten fakte të pa kontestuara sepse shifrat për secilën kategori veç e veç gjinden në raportin në fjalë. Bashkangjitur këtij raporti të transparencës para nesh paraqitet edhe një tabelë me të dhëna të zyrtarëve të cilët janë në punë me kontratë mbi vepër e unë e gjykoj se drejtori i DA, për këtë e di që kjo është një shkelje flagrante në kundërshtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Nuk ka të drejtë institucioni t'i vendos ato shifra sepse fundi skish se çka të vendos se ato paga ishin rreth 190.00€ apo 200.00€, dhe me vendos emra, merreni lexojeni ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe do të vini në konkluzion të saktë. Të nderuar dhe të respektuar qytetarë të Komunës së Podujevës ky është veç fillimi keni durim se do të keni befasi edhe për këta 4 muajt e ardhshëm.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, sa për sqarim Doruntina nuk i ka ndërruar asnjëherë qëndrimet përkundrazi për të gjitha këto shpenzime unë jam konsultuar me drejtorin përkatës. Shpenzimet e telefonisë e kemi ditur më herët se do të rriten për shkak të lansimit të projektit Alo Komuna. Aty njerëzit thërrasin pa pagesë d.m.th, ngarkesa e pagesës i obligohet Komunës kështu që ajo pjesë kanë qenë thirrjet e njerëzve që kanë bërë në telefoni. Sa i përket shpenzimeve të derivateve ju asamblist që jetoni në Podujevë ndoshta e keni parë inspeksionin sa ka qenë aktiv në 3 muajt e parë sa kanë lëvizur me vetura. Drekat dhe darkat zyrtare edhe në këtë kategori e kemi ditur se do të ketë ngritje të shpenzimeve. Personat që kanë punuar në projektin Alo Komuna kanë punuar në mënyrë vullnetare dhe a mendoni se atyre është dashur t'ju paguhet një shujtë brenda ditës sa kanë punuar. Kjo është arsyeja e rritjes së shpenzimeve për dreka dhe darka zyrtare, për këtë arsye unë nuk fola edhe pse i dija arsyet.

z.Hasan Ajeti, theksoi, kolege e nderuar sektori Alo Komuna nuk është themeluar në bazë të procedurave ligjore, pyetjet unë që ia kam bërë drejtorit të DA, fatkeqësisht më ka thënë se nuk e di se kush janë ata punëtor dhe procedurat që janë zhvilluar për ndryshe është shumë e qartë dhe shumë e thjeshtë çka thash unë. Të gjitha këto shpenzime që ti po i referon qenkan në sektorin Alo Komuna, për këtë sektor duhet të na japë sqarime drejtori i respektuar sepse ai është personi përgjegjës për çka është dhe i thirrur. Ajo çka është interes i qytetarëve, askund nuk e kontestuat këtë që unë e lexova, kjo është e saktë këtu të gjitha këto janë shifra që gjinden në këtë raport të bashkangjitur andaj duhet me pas shumë kujdes kur të paraqitet para publikut të dhënat e stafit të punësuar me kontratë mbi vepër sepse ato janë të dhëna personale dhe është mirë me i konsultuar njohësit e fushës të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale sepse gjithçka këtu nuk mund të vendoset sepse ka rregulla. Te përfituesit e subvencioneve në DKRS drejtoresha e DKRS-së, në seancën e fundit ka thënë ejani në zyrë dhe unë ja u jap të dhënat e përfituesve, a ka qenë kështu. Këto që i thashë unë për qëndrimet e tua për fat të mirë është një procesverbal dhe t'i kam lexuar dhe duhet të jesh pak reale lexoi edhe ti sepse janë rritur shpenzimet te drekat zyrtare dhe te furnizimi me pastrim, në naftë për ngrohje, karburant për vetura, furnizim në zyra, furnizim me ushqim dhe pije dhe shpenzimet e telefonisë, mos e përmend sektorin Alo Komuna si argument se e humb luftën sepse sektor Alo Komuna është sektor apo divizion varësisht ashtu siç e quan ti që nuk është i themeluar në pajtim dhe harmoni me ligjet në fuqi.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, Kuvendi Komunal i Podujevës nuk ka nevojë të ketë më shumë punëtor me kontratë mbi vepër sepse këtu nuk janë duke u kryer punët më të thjeshta e lerë më ato punë dhe detyra specifike që stafi s'mund t'i kryej, z. Kryetar këtu ne po debatojmë sepse këtë dokument me miratimin e jua drejtori përkatës e ka sjellë në Kuvend. Sa i përket shpenzimet ju deklaruat se janë ulur shpenzimet mirëpo këto shpenzime ashtu siç e ceku kolegu z.Hasan Ajeti janë rritur sepse për mua dhe secilin këtu që është prezent, 1,216.00€ janë të vlerë më e madhe se 871.00€ ,si i keni llogaritur ju këto shifra nuk e di sepse sipas matematikës kjo është ngritje e dy fishtë e shpenzimeve. Te derivatet 19,031.00€ janë shpenzime më të mëdha se 13,000.00€, sepse janë 6,000.00€ ngritje, ti thua se kemi zbritje por ti s'ke zbritur asgjë.

Prej kohës kur e keni marrë mandatin si Kryetar i Komunës së Podujevës në këtë periudhë kohore ju i keni rritur shpenzimet e punë s'keni kryer asgjë, si Kryetar ndryshëm prej atij të LDK-së ju keni bërë vetëm një veprim për një transformator të energjisë elektrike që e ka vendos KEDS-i në fshatin Dumnicë, këtë që po e them unë është shumë e vërtetë. Për 20 vite në pushtet sa ka qenë LDK-ja ju z.Bahri Selimi sa keni qenë opozitë gjithherë keni qenë kritik dhe ke pyetur se sa punëtor janë të punësuar me kontratë mbi vepër dhe në cilët sektorë janë dhe çfarë detyrash kryejnë, tani ju keni ardhë për ndryshim dhe pyetja ime është sa është numri i punëtorëve kontratë mbi vepër dhe cilat janë detyra specifike që i kryejnë ata në këtë Kuvend Komunal sepse në momentin që kontrata lidhet ajo duhet zbatuar dhe ata persona duhet paguar ashtu sipas kontratës dhe ai ose ajo që ka kontratë të tillë duhet ta kryejë punën sipas kontratës. Alo Komuna dhe eksperimentet që jeni duke i bërë ju ekzibicionet politike dhe mos me pas mundësi me i arsyetuar me dokumentacion këtë vetëm plan programi i Kryetarit Bulliqi dinë ta bëjë. Alo Komuna institucioni duhet të jetë i hapur dhe të kryhen shërbime dhe shpenzimet i bënë ai që thërret e jo ai që përgjigjet në telefon. Ai që thërret ai e bënë shpenzimin, nuk mund të fusësh shpenzime për drekë zyrtare për ata punëtor që punojnë në Komunë. Drekë zyrtare është ajo drekë kur shkon në një vend tjetër me qëllim të caktuar për me sjellë një projekt të caktuar për Kuvendin Komunal dhe mund të thuash se kam qenë në Gjermani dhe e kam marrë këtë platformë dhe dua të punojë sipas kësaj platforme dhe jo punëtorit të Komunës t'i shtrosh drekë zyrtare sepse nuk i takon. Në aspektin moral znj.Doruntinë ju kuptoj sepse është aspekt moral human dhe mund t'i thërrasësh në oda 36 persona që jemi këtu nga një drekë dhe përfundon mandati i Kryetarit Bulliqit andaj pa problem te unë një herë mund t'i sjellësh këta punëtor për drekë por duhet me i'a kthye në atë formë të cilën po e them unë e jo kështu si mundoheni me i arsyetuar.

z.Ragip Fetahu, theksoi, i nderuari kolegj asamblist nga radhët e LDK-së së pari i dëgjova me vëmendje kritikën tuja dhe me të vërtetë unë po befasohej me ato kritika që ju i bëtë. Ju e dini që është muaj i 4 i qeverisjes së Ekzekutivit dhe shpenzimet të cilat ju i cekët janë të domosdoshme për pastërtinë e objektit të cilin ju e keni lënë në atë gjendje. Shpenzimet për mallra janë shpenzime që domosdoshmërisht është dashur të bëhen për atë gjendje të cilën e kanë gjetur këta dhe është dashur që patjetër në terren të dilet dhe të skanohet gjendja dhe për këtë arsye mendoj se janë këto shpenzime dhe janë të arsyeshme dhe të justifikueshme. Kam një sugjerim, 20 vite në pushtet keni qenë ju, dhe 20 të pjesëtohen me 2 rezultati është 10 vite, vetëm të kisha sugjeruar me mbikëqyr se si është menaxhuar dhe është udhëhequr. Unë jam racional në lidhje me këto dhe sa herë që vije pas orës 4 veturat e Komunës i shohë në parking të gjitha. Sa i përket orarit të punës prej orës 08:00-16:00, ato janë obligime që duhet të kryhen sepse ekzekutivi është në fillim të mandatit dhe mendoj se kritikën që po jepni tani në këtë fillim të mandatit për këtë 3 muaj janë totalisht të pa arsyeshme e aq më pak nga LDK-ja.

z.Hasan Ajeti, theksoi, e di që ke dëshirë me qenë protagonist por mos u bë sepse s'ke nevojë.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, kam një replikë për kolegun z.Rafet Lllashtica, që ceku bamirësinë, këta persona që janë bëjnë punë vullnetare në sektorin Alo Komuna. Nuk janë persona që vetëm t'ju bëjë mirë ose diçka tjetër, sa i përket telefonisë mobile nëse se kishim bërë këtë projekt do të kishte kritika të dy anshme kjo është njësoi si ajo thënia popullore “hip se të vrava, zbrit se të vrava”.

z.Agron Hyseni, theksoi, kam dy pyetje për dy kode buxhetore që ka rritje marramendëse të shumave. Në kodin buxhetor 21/200, subvencionet për etnitete jo publike nga 21,926.00€ është 71,795.00€, dhe për kodin 222/00, pagesa për përfituesit individual nga 200.00€ që kanë qenë në vitin 2020, në vitin 2021 është 17,797,75.00€, a ka mundësi me na treguar dikush pse është kjo rritje kaq e madhe e këtyre shpenzimeve.

z.Haki Rudari, theksoi, raporti financiar qoftë ai vjetor apo mujor përfshin informatat në lidhje me shumën e buxhetit në thesar të aprovuar, shpenzimet kapitale, shpenzimet për mallra dhe shërbime, shpenzime për subvencione, të hyrat vetanake, suficit i buxhetit etj. Mendoj se janë 3 indikator të cilët e paraqesin performancën e çdo qeverisje lokale dhe të ish qeverisjes lokale nga LDK-ja. Këta tre faktor apo indikator janë performanca e shpenzimeve, performanca e të hyrave vetanake, projektet kapitale dhe transparenca e tyre. Sa i përket të parave veç se është debatuar më herët nuk kam folur por tani Komuna është ndërlidhur me këtë raport dhe kanë mbetur suficit 1,177,607.00€ nga qeverisja e kaluar, pa u harxhuar kanë mbetur 669,155.00€, nëse dalim me vizita në terren dhe i takojmë bujqit, inxhinier të ndryshëm duke përfshirë edhe strukturat e arsimit dhe shëndetësisë dhe mirëqenies social të gjitha këto kategori janë me vërejtje. Kur nuk ka mjete i kuptoj të gjithë, po të ketë mjete dhe të teprojnë me të vërtetë kjo gjendje është e pa arsyeshme e pa justifikueshme. Sa i përket raportit financiar mund të them që në kuadër të buxhetit financiar shohë zvogëlime natyrisht duke i shikuar rrethanat tjera p.sh, kodi ekonomik nr.13/140 kemi një zbritje 100% nga 3 mujori i viti të kaluar, po ashtu nga kodi nr.13/141, kemi zbritje nga 3 mujori i vitit të kaluar në krahasim me këtë raport 3 mujor, zbritje kemi 64.67%, në kodin nr.13/220, këtë mujor kemi zbritje në krahasim me të njëjtin raport 3 mujor të vitit të kaluar, këto janë shifra të cilat unë po i lexoj në këtë raport financiar. Kemi edhe një zbritje 100%, në kodin 13/480, te kodi nr.14/010 kemi zbritje 53.78%, te shpenzimet e vendimeve të gjykatave kemi zbritje nga 73,942.00€, tash në këtë tre mujorin kemi 12,639.00€, dhe një element po e ceku se cila është performanca e qeverisjes së varur ku njëri nga to janë të hyrat vetanake, nëse e marrim dhe e analizojmë raportin tre mujor kemi 20.58%, rritje të hyrave vetanake nga qeverisja aktuale. Shifrat të cilat janë duhet t'i respektojmë të gjithë prandaj secila qeverisje nuk mund të punojë pa harxhime, në këtë drejtim është mirë të reflektojmë dhe t'i marrim për bazë raportet zyrtare e assesi ato të cilat mund t'i shpik dikush.

z.Adnan Zymeri, theksoi, kam një pyetje sa i përket projekteve kapitale që janë bërë për vitin 2021, figuron një pagesë që i është bërë organizatës Help, në mbështetje të stabilitetit socio-ekonomik në Kosovë. Situacioni i parë prej 18,000.00€, andaj pyetja është se me çfarë logjike drejtor ju keni me ua pranuar subvencion, do të thotë, mbështetje e me u listuar te projektet kapitale. Ky është një keq kategorizim brenda kategorive ekonomike dhe auditori këtë duhet ta paraqes si shkelje.

z.Fatlum Osmani, drejtor DBF-së, theksoi, lidhur me pagesën për organizatën Help, që është bërë nga kategoria e investimeve kapitale, këtë vërejtje është dashur me bë kur është bë planifikimi i buxhetit për vitin 2021 por ju i keni kategorizuar te investimet kapitale projektet me bashkëfinancim në kuadër të DPZHE, ai ka qenë projekt me bashkëfinancim. Këto keq klasifikime që ti i thua me të drejtë që kanë qenë në planifikim tani Ministria e Financave nuk i lejon arsyeja pse janë këto mjete nga kategoria rezervë janë bërë për shkak të keq klasifikimeve që ju i përmendët mirëpo ata i kanë shikuar vetëm këto projektet e reja të cilat nuk kanë qenë mjete paraprake, përndryshe t'i kishin shikuar të gjitha projektet tjera sigurisht që shumë projekte tjera do të ishin në kategorinë rezervë por

këtu është problemi kur është bërë planifikimi i buxhetit dhe kjo është renditur te kategoria e investimeve kapitale. Janë afër 102,000.00€, mjete financiare të cilat kur janë paguar në fundin e vitit 2020, kur ne e kemi marrë udhëheqjen e ekzekutivit në fund të muajit dhjetor 2020, Ministria e Financave për shkak të bilancit bankar këto mjete i ka kthyer mbrapa. Rrjedhimisht ato fatura është dashur të paguhet por herën e dytë për arsye se operatori ekonomik, qytetarëve nuk ju kanë dalë mjetet në llogari, thesari e ka atë të drejtë. Ky ka qenë problem i të gjitha komunave arsyeje pse ka ardhë deri këtu është se më datën 10 dhjetor 2020 i kemi gjetur 4,200,000.00€, të pa shpenzuara, prej tyre kemi arritur t'i shpenzojmë afër 2,000,000.00€, të tjerat s'kanë arrit me kryer punë dhe janë kthyer në grant qeveritar. Subvencionet për bashkësinë Islame të cilat i ceku asamblisti z.Rafet Llapashtica, ju informojë se nga asambleja komunale është marrë vendim për subvencionimin e çdo personi të vdekur, Bashkësia Islame e sjellë faturën dhe në DBF jem të obliguar në bazë të vendimit të asamblesë Komunale me bë ekzekutimin e asaj fature. Subvencionet të cilat i përmende në raste të vdekjes së një anëtar i të familjes të cilën e sqaroj Kryetari ato janë të përcaktuara me ligj dhe është obligim ligjor për të gjithë zyrtarët komunal që fatkeqësisht ju vdes një anëtar i familjes jemi të obliguar të bëjmë këtë pagesë nga kategoria e subvencioneve. Sa i përket dinamikës së shpenzimeve, unë kur e procedova raportin financiar u përpjeka t'i përcaktoj dy faktor, e para ka të bëjë me çështjen e kushteve klimatike ku investimet nuk fillojnë deri në muajin prill ose maj. Në muajin prill ne kemi një ekspansion të shpenzimeve, njëkohësisht dhe të investimeve, po flas për periudhën janar - mars, gjithashtu janë edhe procedurat e prokurimit p.sh, për kategorinë e mallrave që zhvillohen procedurat e prokurimit dhe rrjedhimisht për kontratat të cilat janë aktive edhe për subvencionet janë 760,000.00€, ku edhe për këto ka procedura dhe fatmirësisht për të gjitha projektet kanë filluar të gjitha procedurat si në DPZHE, DKA për bursa është shpallë konkursi dhe sa kam njohuri është në fazën vlerësimit dhe të finalizimit, subvencione në fushën e shëndetësisë, DKRS-së, ku së shpejti do të mbyllet dhe do të bëhet ekzekutimi i pagesave.

z.Agron Hyseni, theksoi, kam një pyetje i nderuari drejtor gjatë sqarimeve tuaja ju përmendët disa herë fondin rezervë, pyetja është a ka kod buxhetor ky fond rezervë, nëse s'ka kod buxhetor atëherë ku ruhen paratë.

z.Fatlum Osmani, drejtor DBF-së, theksoi, ato janë kategori rezervë kode buxhetore kanë projektet, ato mjete Ministria e Financave i ka vendos në kategorinë rezervë dhe fatmirësisht Ministria e Financave ka bërë lëshime te udhëzimet administrative në të gjitha pikat se përndryshe i gjithë buxhetin është dashur të kthehet prej kategorisë rezervë në buxhet sepse kanë bërë shaka me programet e investimeve publike vetëm kanë bërë (x) dhe s'kanë bërë asnjë arsyeshmëri për projekte dhe i kanë nënshkruar drejtorët e drejtorive përkatëse dhe fatmirësisht Ministria e Financave ka bërë lëshime te udhëzimet administrative se për ndryshe i tërë buxheti do të ishte në kategorinë rezervë pa kode.

z.Bahri Selimi, drejtor DA, theksoi, po u përgjigjem dy pyetjeve të dy këshilltarëve njërit nga LDK-ja dhe tjetrit nga PDK-ja, të cilëve po ju bëjnë përshtypje ende kontratat mbi vepër. I nderuari z.Hasan Ajeti para se të jap përgjigjen ju rikujtoj se kur e kemi marrë udhëheqjen e ekzekutivit kanë qenë 57 punëtor me kontratë mbi vepër, kurse tani nuk është asnjë. Në objektin e Komunës nuk është asnjë punëtor me kontratë mbi vepër. Janë 4 shofer në kuadër të QKMF-së, të cilët janë dërguar në qendrën anti covid, atyre kontratat ju skadojnë më datë 13 maj 2021. Sa i përket kontratave tjera dhe për pagesat që u përmenden më herët, është një kontratë që është lidhur në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenie Sociale dhe Entit të Punësimit në Podujevë, kështu duhet ta keni të qartë ju z.Rafet Llapashtica se kur kam qenë asamblist kam pyetur për këto kontrata por me udhëheqjen e ekzekutivit ne këto kontrata i kemi ndalua. Sa i përket sektorit Alo Komuna që u përmend shumë, si projekt unë e di që për disa është i papranueshëm për shkak se sektorit Alo

Komuna e paraqet një transparencë të Komunës dhe e ka ofruar shumë qytetarin me Komunën. Unë ju them se sektori Alo Komuna nuk është sektor anti ligjor i nderuari z.Hasan Ajeti, gjeje dispozitën ligjore që është anti ligjore dhe bisedojmë pastaj. Puna vullnetare është shumë mirë e rregulluar me ligjin e punës.

z.Hasan Ajeti, theksoi, i nderuari drejtor a ka mundësi të na i tregoni emrat e këtyre punëtorëve në sektorin Alo Komuna.

z.Bahri Selimi, drejtor DA, theksoi, në sektorin Alo Komuna punojnë punëtor të ndryshëm dhe nuk ia di emrat të gjithëve sepse ata janë vullnetarë dhe shumë e thjeshtë është shkojmë së bashku në sektorin Alo Komuna dhe i pyesim së bashku secilin/en se si quhet sepse ata janë duke punuar aty.

z.Hasan Ajeti, theksoi, ju e dinë shumë mirë se kush janë emrat e përveçëm por në qoftë se nuk i dini këta emra kjo është shqetësuese se të punojë dikush në institucion të pushtetit lokal dhe mos të dihet se kush janë ata ose ato kurse ne asnjëri nuk i besojmë kësaj teorie sepse këto janë teori dhe të lutem këto teori nuk ndezin se përderisa i ke përfshirë në raport financiar ata punëtor që thua se janë vullnetarë, prej tyre ka që janë me pagë mujore e që janë pjesë e sektorit Alo Komuna, këtu diçka është gabim. Nuk u përgjigje në pyetjen time sepse nuk është ligjore ana procedurale për të cilën e ke themeluar ti këtë divizion apo sektor Alo Komuna, merri aktet ligjore dhe lexoj mirë konsultohu edhe me shkëlqesinë e tij z.Bajram Ajeti, për këtë pikë dhe një gjë të cilën ju duhet ta dini e besoj që ju e din shumë mirë se kontratat mbi vepër që i'u referove se kanë qenë punëtor me kontrata të tilla mirëpo tani nuk janë, unë ju sqaroj se këto kontrata janë të ndaluara me ligjin për zyrtarët publik, në qoftë se këto kontrata i ka bërë LDK-ja atëherë i ka bërë me ligjin tjetër që ka qenë në fuqi dhe në qoftë se ka bërë keq tani ju jeni në pushtet dhe mos u thirrni në atë se këto të këqija i ka bërë LDK-ja, dhe me nxjerrë argument se LDK-ja i ka lënë të gjitha.

z.Agron Hyseni, theksoi, i nderuari drejtor i DA ju theksuat se punëtorëve në sektorin Alo Komuna ju nuk ia dini emrat atëherë më tregoni se si ua keni paguar shpenzimet e shujtave këtyre punëtorëve pasi që janë rritur shpenzimet buxhetore.

z.Bahri Selimi, drejtor DA, theksoi, nuk është bërë pagesa për punëtorët me kontratë mbi vepër. Sa i përket emrave unë e ceka më herët se ata janë punëtor të cilët ndërrohen herë pas here dhe nuk janë të njëjtit gjithë herë dhe pakë më herët u përgjigja në pyetjen e juaj drejtori i DBF-së, edhe një herë prapë po ju them kur të dalim nga Kuvendi mund të shkojmë së bashku dhe t'i pyesim se si i kanë emrat ata/ato punëtor/e se për besë nuk ua di emrat të gjithëve.

z.Hasan Ajeti, theksoi, për me realizuar këtë ti dhe Shpejtimi është temë tjetër por s'është një realizim ky ju lutem ju respektoj si ty dhe atë si Kryetar por bëhu transparent real trego sepse ti po thirrresh në llogaridhënie dhe në transparencë andaj trego se me çfarë të drejte punojnë ata njerëz aty, ceki me emra sepse ne e dimë se ata janë anëtarë të LVV-së. Ne e dimë këtë dhe ti del e lexohesh shumë keq në rast ku del e deklarohesh se nuk e dinë se kush janë ata ose ato vullnetar/e.

z.Bahri Selimi, drejtor DA, theksoi, çka me bë ne që veç LVV-ja ka vullnetarë e ju nuk keni vullnetarë.

z.Hasan Ajeti, theksoi, kjo që e thatë është temë tjetër dhe këtu e ke prezent z.Ragip Fetahu që mund të flasë në mënyrë profesionale për këtë temë, andaj dil dhe trego me emra të përveçëm se kush janë këta persona.

z.Ragip Fetahu, theksoi, në lidhje me këta punëtor unë e njohë (Kaltrinën dhe Sebastianën) dhe z.Hasan Ajeti të lutem se kjo është një mundësi sa do pak e vogël që ju jepet të rinjve të lidhen me projektet e përgjithshme komunale dhe në vend që ta thuani këtë ju po fillon me kritika dhe akuza dhe 20 vite me i pjestu me 2 vite del barazimi 10 vite.

z.Hasan Ajeti, theksoi, i nderuari z.Ragip Fetahu ju thashë më herët se keni dëshirë me qenë protagonist së shpejti do të mbahen zgjedhjet lokale dhe kandidatët merri këtu i ke.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se përfunduar me debate rreth kësaj pike të rendit të ditës, andaj e konsideroj të përfunduar, dhe vazhdojmë me punë sipas rendit të miratuar të ditës.

4. Propozim vendim për vënie në diskutim publik të propozim Rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës sigurisht jeni në dijeni se e njëjta ka qenë pikë edhe n'kuadër të rendit të ditës në mbledhjen e kaluar, por që nga Ekzekutivi i Komunës është përsëritur sërish për këtë mbledhje.

z.Bahri Selimi, drejtor DA, theksoi, mbështetur neni 34 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, neni 28, të statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, udhëzimin administrativ (MAPL), nr.08/2008, por edhe udhëzimin administrativ të (MAPL) i cili e shfuqizon të mëparshmin ne nuk kemi arritur ende që të nxjerrim një rregullore për riorganizimin dhe funksionalizimin e këshillave të fshatra, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës. Sot para vetes keni propozim vendimin e Kryetarit të Komunës për vënie në diskutim publik të propozim rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës. Sigurisht jeni në dijeni se rregullorja në fjalë është proceduar në Kuvend më datë 09.09.2020, dhe ka marrë pëlqimin për diskutim publik por për shkak të masave të mara për parandalimin dhe luftimin e virusit Covid-19 është marrë vendim që kjo rregullore të shtyhet për një kohë të pacaktuar, po ashtu e njëjta është proceduar në kuvend më datë 08.04.2021, po sërish është shtyrë për një mbledhje të radhës me të njëjtën arsye. Konsideroj se tani është koha që kjo rregullore të marrë prapë pëlqimin e Kuvendit që të dal në diskutim publik dhe siç jeni në dijeni tani është marrë një vendim nga Qeveria e Republikës së Kosovës për masa të reja në bazë të cilave mund të mbajmë diskutime dhe debate publike natyrisht duke i respektuar masat. Duke marrë për bazë lehtësimin e masave dhe mundësisë së mbajtjes së debateve publike në këtë kohë dhe situatë që jemi konsiderohet se është e mundshme të organizohen debate në lokalitete të ndryshme në Komunën e Podujevës. Me këtë propozim vendim kërkohet që Kuvendi i Komunës të caktojë kohëzgjatjen e diskutimit publik datat kohën dhe lokalitetet e mbajtjes së debateve publike për propozim rregulloren në fjalë në këtë rast ne propozojmë që diskutimi publik caktohet të mbahet nga data 05.05.2021 deri më datë 07.06.2021, ndërsa debatet publike mbahen në lokalitetet si në vijim, debati publik me banorët e fshatit Kërpimeh dhe fshatrave për rreth të mbahet më datë 11.05.2021, ora 14:00, në objektin e shkollës së fshatit Kërpimeh. Debati publik me banorët e fshatit Lluzhan dhe fshatrave për rreth të mbahet më datë 12.05.2021, ora 14:00, në objektin e shkollës së fshatit Lluzhan. Debati publik me banorët e fshatit Orllan dhe fshatrave për rreth të mbahet më datë 18.05.2021, ora 14:00, në objektin e shkollës së fshatit Orllan. Debati publik me banorët e qytetit të Podujevës të mbahet më datë 19.05.2021, ora 14:00, në sallën e mbajtjes së mbledhjeve në objektin e ri të Komunës. Ne sot kërkojmë nga Kuvendi i Komunës që ta mbështetë këtë propozim vendim në mënyrë që të krijohen mundësitë dhe aspektet procedurale për zhvillimin e debateve publike me qëllim të transparencës dhe draftimit sa më të mirë të rregullore finale që do të sjellët sërish në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.

z.Hasan Ajeti, theksoi, ne grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së mendojmë që propozim vendimi për diskutim publik i kësaj rregulloreje nga koha që ekzekutivin e ka qeverisë LDK-ja, do të

ketë telashe në vazhdimësi sepse kjo rregullore ka të bëjë me pagesën e atyre që nesër do të jenë bartës të këtij pushteti në rast se mund t'ju themi si kryetar të lokalitetit të fshatrave pasi që kemi një organizim të ri me këtë rregullore vetë fakti më shumë se dy fshatra janë inkorporuar në një fshat dhe askund nuk përmendet vlera e pagesës se cila do të jetë. Shqetësuese është caktimi i debateve në lokalitetet e cekura, nga lokaliteti që vijë unë dhe fshatrat për rreth nuk është caktuar të mbahet diskutimi publik këto fshatra janë të mëdha në aspektin gjeografik dhe me numër të popullsisë, si përfundim LDK-ja gjykon se ky propozim vendim duhet të shtyhet pasi që do të ketë telashe sipas këtij organizimi që parashihet në propozim vendim.

z.Ragip Fetahu, theksoi, ne grupi i këshilltarëve të LVV-së e përkrahim këtë propozim rregullore sepse kjo rregullore mundëson kombinimin e demokracisë drejtpërdrejtë dhe u mundëson qytetarëve të jenë më aktiv në vendimmarrje dhe kontakt direkt me politik bërjen. Kjo rregullore është në përputhje me ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe me udhëzimin administrativ të vitit 2008 dhe UA02/219, po ashtu është në përputhje me strategjinë nacionale për vetëqeverisjen lokale për periudhën 2016-2026, prandaj ne e përkrahim këtë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, në parim ne e mbështesim këtë rregullore por desha të debatojë rreth organizimit të debateve publike që i paraqiti drejtori. Nuk është një organizim i mirë i debateve për arsye se drejtori i kishte paraparë takime për diskutime publike në fshatrat Kërpimeh, Orlla, Lluzhan dhe në qytet, e këto lokalitete janë vende që kanë numër më të vogël të banorëve dhe mund të jetë pjesëmarrja më e vogël e qytetarëve në këto debate. Fshatrat Shajkoc, Sfeçël, Dumosh që kanë më tepër se 2000 banor e mos të mbahet debat publik në këto lokalitete e të caktohet debati publik në fshatin Kërpimeh dhe fshatrat për rreth që të gjitha nuk kanë banorë sa fshati Sfeçël nuk është e arsyeshme. Propozoj që në fshatin Gllamnik dhe fshatrat Llapashticë e Epërme dhe Llapashticë e Poshtme të caktohet mbajtja e një debati publik, kështu që të rishikohet mundësia e mbajtjes edhe të 2 ose 3 debateve por edhe në qytet do të ketë probleme lidhur me organizimin e një debati publik kur dihet se salla e Kuvendit ka hapësirë vetëm për 35 persona ky ishte propozimi im.

z.Bahri Selimi, drejtor DA, theksoi, para se me e hedhë në votim këtë propozim rregullore unë po e jap një propozim në bazë të kërkesave tuaja që diskutimi publik me qytetarët e fshatit Sfeçël dhe fshatrave përreth të mbahet më datë 17.05.2021 në ora 14:00, objekti i shkollës, diskutimi publik me qytetarët e fshatit Gllamnik dhe fshatrave përreth të mbahet më datë 19.05.2021 në ora 14:00, objekti i shkollës, kurse diskutimi publik në qytet të mbahen më datë 20.05.2021 në ora 14:00, salla e mbledhjeve të Kuvendit Objekti i ri i Komunës dhe më datë 21.05.2021 do të mbahet diskutimi publik në shkollën Xheladin Rekaliu ora 14:00.

z.Fatmir Gashi Kryesues i Kuvendit, theksoi, nëse dikush nga ju ka diçka për të shtuar rreth kësaj pike të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas materialit përkatës dhe propozimeve të dhëna nga drejtori i Drejtorisë së Administratës.

Pas votimit, kryesuesi i Kuvendit konstatoi, se me 14 vota për, 2 vota kundër dhe 13 vota të përmbajtura, miratohet Propozim vendimi për vënie në diskutim publik të propozim Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatra, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës, dhe atë:

*-Debati publik me banorët e fshatit **Kërpimeh** dhe fshatrat përreth mbahet më **11 maj 2021** duke filluar nga ora **14:00**, në shkollën e fshatit Kërpimeh.*

*-Debati publik me banorët e fshatit **Lluzhan** dhe fshatrat përreth mbahet më **12 maj 2021** duke filluar nga ora **14:00**, në shkollën e fshatit Lluzhan.*

*-Debati publik me banorët e fshatit **Sfeçël** dhe fshatrat përreth mbahet më **17 maj 2021** duke filluar nga ora **14:00**, në shkollën e fshatit Sfeçël.*

-Debati publik me banorët e fshatit Orllan dhe fshatrat përreth mbahet më **18 maj 2021** duke filluar nga **ora 14:00**, në shkollën e fshatit Orllan.

-Debati publik me banorët e fshatit Gllmanik dhe fshatrat përreth mbahet më **19 maj 2021** duke filluar nga **ora 14:00**, në shkollën e fshatit Gllmanik.

-Debati publik (1) me banorët e qytetit të Podujevës mbahet më **20 maj 2021** duke filluar nga **ora 14:00**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit – ndërtesa e re e Komunës.

-Debati publik (2) me banorët e qytetit të Podujevës mbahet më **21 maj 2021** duke filluar nga **ora 14:00**, në shkollën fillore “Xheladin Rekaliu”

Kryesues i Kuvendit, propozoi pauzë për rreth 45 minuta, për çka u mbështet nga anëtarët e Kuvendit.

Pauza nga ora 12:15.

Pas pauzës, mbledhja vazhdoi duke filluar në ora 13:05.

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi kuorumin (sipas listës së nënshkruar)

5. Propozim Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa tarifa dhe gjoba Komunale

- Propozim vendimi për diskutim publik

z.Pajtim Balaj, drejtor i DPZHE, theksoi e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, një vit me parë si një ndër masat për ndihmë të bizneseve lokale pas goditjes që na dha pandemia, me shumicë votash ky Kuvend ka marrë vendim që t'i liron të gjitha bizneset nga taksa komunale vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste deri në fund të vitit 2020. Me sa më kujtohet ka pasur një pajtueshmëri të përgjithshme që kjo taksë përtej situatës pandemike duhet të hiqet si një lehtësim për të bërit biznes. Prandaj, sot bazuar në ligjin 03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal, kreu 2 për taksat komunale dhe neni 10, në emër të Kryetarit të Komunës z. Shpejtim Bulliqi i propozoj Kuvendi që ta miratoj për hedhjen në diskutim publik Rregulloren për ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Taksa, Tarifa dhe Gjoba Komunale të datës 18 shkurt 2018, të draftuar nga Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik si vijim: Neni 6 i rregullores së vitit 2018 riformulohet me tekstin si vijon, taksat komunale vjetore për ushtrimin e veprimtarisë afariste, pika 1. Subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarin e tyre në territorin e Komunës së Podujevës janë të liruara nga taksat komunale vjetore me përjashtim të bizneseve, kategorive të bizneseve që janë si në vijim: institucionet financiare, pagesave dhe transfereve me 100.00€ në vit, institucionet mikrofinanciare kreditore me 1000.00€ në vit, bankat 2000.00€ në vit, kompanitë e sigurimeve 300.00€ në vit, kompanitë e telekomunikimit të telefonisë mobile me 1000.00€ në vit, kompanitë e shpërndarjes së internetit nga rrjeti kabllor 300.00€ në vit, терминалет doganore 2000.00€ në vit, qendrat tregtare me sipërfaqe prej 500-1000 m² me 500.00€, me sipërfaqe prej 1000-2000 m² me 1000.00€ dhe me sipërfaqe mbi 2000 m² me 2000.00€. Krahas kësaj pika 2.9 flet edhe për pompat e derivateve si ne i kemi kategorizua edhe pse e dimë që pompat në një fshat të thellë nuk mundet të barazohet me një pompë në qytet ose në magjistrale për shkak të qarkullimit të madh që kanë i kemi nda në dy zona, zona 1 përfshin qytetin dhe magjistralen deri në Lupç me 100.00€ për aparat mbushës kurse zonat tjera që janë kryesisht nëpër fshatra jashtë qytetit dhe jashtë magjistrales me 30.00€ për aparat mbushës. Do të jetë vetëm një draft dhe mospajtimet, kritikrat që mund t'i keni, propozimet për ndryshime ne i mirëpresim dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj. Periudha e diskutimit publik zgjat nga data 05 maj deri me 07 qershor kurse data e debatit publik është me 17 maj në ora 10:00 salla e Kuvendit Komunal.

z.Hasan Ajeti, theksoi, e dëgjuam me vëmendje drejtorin lidhur me këtë plotësim ndryshim për Rregulloren për Taksa dhe Tarifa, grupi i këshilltarëve të LDK-së e ka shqyrtuar materien dhe në bazë të propozimit del një diskriminim ekstrem i vlerës me situatën pandemike që është vetëm në komunën apo edhe në nivel të Republikës, po ashtu, propozimi nuk përputhet as me propozim vendimin tjetër që vjen pikërisht nga ky ekzekutiv që thotë për lirim nga taksa komunale në qoftë se një kategori e lirojmë nga taksa kurse tjetër kategori i ngrisim taksa për ne si grup nënkuptohet që jemi kundër, vlera besoj që është jashtëzakonisht e lartë dhe në rastin konkret shikoni rregulloren në fuqi nëse nuk gaboju për bankat është vlera vjetore 250.00€ taksë vjetore ndërsa me propozim tuaj 2000.00€, nëse shkojmë tek терминалет doganore është 250.00€ e keni bërë 2000.00€, në qoftë se shkon tek sipërfaqet e metrit katror prej 500-1000 ka qenë 125 ma e larta 250.00€ e tash është 500.00€, sipërfaqe 1000-2000 m² ma e larta ka qenë shuma 500.00€ e tash 1000 € dhe mbi 2000 m² tarifa ma e lartë ka qenë 625.00€ e tash është mbi 2000.00€. Duke e pa gjendjen pandemike drejtor që sot ne jemi gjykoj që në rast se kalon edhe pse ne si grup t'i japim arsyet pse nuk e mbështesim këtë në rrethanat që sot gjendet vendi ynë dhe që ka elemente të diskriminimit dhe standarde të dyfishta e nëse shkojmë me këtë që një kategorie t'i shtojmë dhe tjetër t'i heqim taksa gjykoj që nuk është punë e mirë por sidoqoftë kjo është punë e pushtetit në këtë rast e Lëvizjes, qëndrimi i LDK-së është kundër këtij ndryshimi.

z.Patriot Rudari, theksoi, ne grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e përkrahim vendimin për diskutim publik që është një vendim i qëlluar prej të cilit varet zhvillimi i mëtejshëm ekonomik dhe jepet mundësia që t'i krijojmë lehtësira këtyre bizneseve.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, draft rregullorja do të dalë në debat publik, është e vërtetë që vitin e kaluar të gjitha partitë politike kanë qenë me një qëndrim unanim dhe Kuvendi Komunal i Podujevës me sa di unë e ka pas normën ma të ulët të tatimit ku nuk e lejojnë normën ma e ulët sipas ligji dhe udhëzimet administrative për shkak të gjendjes. Asamblisti z.Hasan Ajeti më lartë ceku vërejtjet dhe unë nuk dua me shqyrtua se cilët parametra i ka marrë drejtori për me ngrit taksën komunale p.sh, prej 250.00€ në 2000.00€ për m² për objektet afariste që janë mbi 500m² ndërsa në anën tjetër i zbresim taksat por në fakt taksat rriten me shumën që e ka ndryshuar sepse këto subjektet tjera kanë dhënë 70.00€ për 3 muaj për taksa të rregullta komunale i bie 120.00€ në vit e kështu që duhet mbi 20 ose 30 operator ekonomik të lirohen nga taksa për me zënë tarifën e këtij që ju ka rritë taksa prej 250.00€ në 2000.00€, kështu që për këtë barazimin jemi pak skeptik drejtor. Tek kjo ndarja e zonave për pompa në 1 dhe 2 po më pëlqen që nuk i ke bërë të barabarta me pozicionime sepse zona duhet me u nda dhe duhet të caktohen tarifa e që është në rregull por tek ky ndryshimi që është bërë nuk e di dhe të them të drejtën udhëzimet administrative dhe ligjet nuk i kam shikuar mirëpo këtë ngritjen që e ke bërë është rritje 300% prej 350.00€ në 2000.00€.

z.Agim Behluli, theksoi, të gjitha komunat tjera e kanë larguar këtë taksë mirëpo ne në këtë situatë pandemie që jemi e që i ka lanë pasojat e veta është mirë që së paku të mbesin ato taksa që kanë qenë e mos të ngritën këto shuma sepse janë të pa përballueshme, te pompat e benzinës unë e kam një vërejtje sepse aparati mund t'i ketë më shumë se 2 dalje dhe këtë nuk e keni llogaritur. Taksat i keni ngritur dhe e keni rënduar ekonominë duke i rënë në qafë me shqiptimin e gjobave kurse tani me ngritjen e tarifave llogarisni një gjë se gjendja e ekonomisë është shtri për toke sepse ka 1 vit e gjysmë me përjashtim të marketeve të mëdha që qeveria ju ka ndihmua e që unë kam qenë kundër atëherë edhe prapë jam kundër kësaj ndihme. Qeveria ju ka ndihmua me pako ekonomike disa bizneseve me nga 1,000,000.00€, e disa biznese që kanë përfituar prej kësaj pakoje më shumë se sa në kushte normale. Të kthehemi në Komunën tonë ku tarifat dhe gjobat janë shumë të mëdha dhe absolutisht të pa qëndrueshme sepse ne mund t'i rrisim tarifat por në realitet këto tarifa s'mund të realizohen sepse bizneset s'kanë mundësi me i përballuar këto ngritje të taksave. Propozimi im është

të hiqen këto taksa dhe tarifa komunale sepse kjo është tepër e pa drejtë për bizneset sidomos për gastronomi që është shkatërrua jo vetëm në Podujevë por në gjithë Kosovën. Në Komunën e Podujevës është çdo send i tepruar duke llogaritur se si funksionon ky qytet prej ndërmarrjeve, që s'dua t'i përmend me emra të subjekteve afariste e deri tek ish hotel Llapi, ne e dimë se që 1 vit e gjysmë nuk ka funksionuar asgjë hiç edhe prapë me i ngarkuar me taksa tarifa nuk është në rregull. Dua të them edhe diçka tjetër jashtë kësaj se çka janë të gjitha këto debate publike, ne nuk po mundemi me u kuptua këtu 30 vetë e jo 300 vetë në debat, merruni me punë konkrete e leni shakatë se janë lodhë njerëzit njëkohësisht dhe ne.

z.Ragip Fetahu, theksoi, drejtor ju lutem a mundeni me na sqarua shkurt se ku ngriten çmimet për taksat komunale dhe ku lirohen do të thotë te cilat biznese.

z.Pajtim Balaj, drejtor i DPZHE, theksoi, edhe një herë e përsëris që ky është vetëm një draft pra nuk po e hedhim ndryshimin në votim sot. Gjatë muajit kur do të mbahet diskutimi publik dhe kur do të caktohen datat se kur do të mbahen dëgjimet publik ne do të marrim çdo propozim që do të sjellët për votim. Pa votën e juaj nuk mundet me u kaluar ky draft, unë nuk mundem me marrë vendim, ju e keni fuqinë dhe ju jeni të zgjedhur të qytetarëve. Ta hedhim sot në votim këtë draft dhe t'i japim miratim për me dal në diskutim publik, vërejtjet që i keni ne jemi të hapur me i marrë, nuk i dimë të gjitha mundet me ndodhë që kemi gabuar dikund, por t'i japim miratim për debat publik pastaj gjatë periudhës një mujore ulemi dhe gjejmë një zgjidhje ideale për të gjithë. Në lidhje me pyetjen e këshilltarit z.Ragip Fetahu i nderuar më fal po nuk e kam rregulloren e vjetër me vete por në përgjithësi janë të gjitha bizneset ashtu siç i keni marrë materialet që janë të përshkruara, në rregulloren për plotësim ndryshim janë kryesisht biznese që tarifa ju është ngritur, kurse të gjitha bizneset tjera duke përfshirë edhe gastronominë që pandemia e ka goditur më shumë janë të liruar pra nëse veç hynë në fuqi kjo rregullore. Sot është vetëm propozim për dalje në dëgjim publik që është vetëm çështje procedurale, shumë më e lehtë për ne do të ishte ta hedhim vetëm në votim dhe mos të humbim kohë mirëpo procedurat na thonë kështu.

z.Fatmir Gashi Kryesues i Kuvendit, theksoi, nëse dikush nga ju ka diçka për të shtuar apo plotësuar rreth propozim rregullores në fjalë urdhëroni, nëse jo atëherë propozim rregulloren në fjalë e hedh në votim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me 8 vota për, 14 vota kundër dhe 5 vota të përmbajtura, nuk miratohet propozim vendimi për vënje në diskutim publik të propozim rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa tarifa dhe gjopa komunale.

6. Propozim Rregullorja e punës së Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit të Podujevës “Avdush Hasani”

- Propozim vendimi për diskutim publik

z.Elhame Kutlovci, drejtoreshë DKRS, theksoi, para jush kam sjellë propozim vendimin për diskutim publik për rregulloren e këshillit drejtues të Teatrit “Avdush Hasani”. Teatri “Avdush Hasani” është institucion i pavarur i cili vepron me ligjin për teatro dhe me statutin e teatrit, Këshilli Drejtues emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari i Komunës dhe në momentin e emërimit ka të drejtë ligjore të bëjë politikën për zhvillimin e teatrit dhe të miratojë shfaqje teatrore që do të realizohen brenda teatrit. Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e punës së këshillit drejtues të teatrit publik të qytetit të Podujevës “Avdush Hasani”. Këtë rregullore e ka të miratuar edhe Komuna e Prishtinës e

cila e rregullon edhe fuqizon të drejtat e këshillit drejtues të teatrit. Kjo rregullore është e mbështetur në ligjin për teatro dhe statutin e teatrit “Avdush Hasani”, andaj, propozoj që të dal në diskutim publik nga data 5 maj 2021 deri më 06 qershor 2021, ndërsa propozoj që debati publik me qytetar të mbahet më 10 maj 2021 në ora 10:00 në sallën e Kuvendit Komunal. Propozimet, sugjerimet apo vërejtjet eventuale mund të drejtohen në formë elektronike tek zyra e informimit dhe tek zyrtarja për kulturë Teuta Ismajli në email adresën teuta.ismajli@rks-gov.net, është e rëndësishme që ne si institucion të rregullojmë ligjërisht të gjithë konkurrentët që funksionojnë në teatër. Jeta kulturore është shumë e rëndësishme për shoqërinë tonë e në veçanti teatri duhet të funksionoj në të gjitha aspektet ligjore në mënyrë që të kemi mundësitë që të krijojmë art të mirëfilltë brenda komunës sonë, andaj, ju ftoj që bashkërisht të bëjmë një punë të mirë dhe të punojmë në funksionalizimin e jetës artistike të komunës sonë dhe ta mbështesni këtë propozim vendim të kësaj rregullore.

znj.Valbonë Kadriu-Podvorica, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së e mbështesim këtë propozim rregullore të punës së Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit të Podujevës “Avdush Hasani”.

z.Bahri Blakçori, theksoi, duke u bazuar në propozimin e bërë nga DKR-së, lidhur me rregulloren e punës së Këshillit Drejtues të Teatrit “Avdush Hasani” ne Grupi i asamblistëve të LVV-së, e përkrahim këtë rregullore e cila përcakton organizimin dhe mënyrën e punës së këshillit në fjalë. Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, udhëzimeve dhe akteve tjera normative, Kryetari ka propozuar vendimin për vënie në diskutim publik e që u cek se do të zgjatë 30 ditë, mendoj që gjatë kësaj periudhe kohore do të jenë të involvuar njerëz të vullnetit të mirë dhe profesionist në mënyrë që të kemi një Teatër dhe një rregullore sa më cilësore.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e mbështesim këtë propozim vendim për vënie në diskutim publik të draft rregullores në fjalë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, e hedh në votim propozim vendimin për vënie në diskutim publik të propozim rregullores sipas kësaj pike të rendit të ditës, përfshirë edhe propozimet e dhëna që ndërlidhen me kohëzgjatjen e diskutimit publik dhe çështjeve tjera përkatës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri u miratua propozim vendimi për vënie në diskutim publik propozim Rregulloren punës së Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit të Podujevës “Avdush Hasani”, sipas materialit përkatës dhe konatstimeve nga mbledhja e KPF-së, dhe atë; Diskutimi publik zgjat nga data 05 maj 2021 deri më 07 qershor 2021, ndërsa debati publik me qytetarë dhe mbahet më 10 maj 2021 duke filluar nga ora 14 ;00, në ndërtesën e re të Komunës, kati përdhes - salla e mbledhjeve.

7. Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare - për subvencionimin e bashkëfinancimit të ndërtimit të shtëpive të banimit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit në Komunën e Podujevës, me Shoqatën Bamirëse “Jetimat e Ballkanit”

z.Driton Velu, drejtor DSHMS, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike, ndër të tjera theksoi, është fjala për një propozim vendim që ne kërkojmë nga ju që ta përkrahni e që bëhet fjalë për marrëveshjen ndërmjet Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit” dhe Kryetarit të Komunës për

subvencionimin e bashkëfinancimit për ndërtimin e 10 (dhjetë) shtëpive. Komuna jonë do të participoj me nga 5000.00€ për secilën shtëpi e që shuma totale për komunën tonë do të jetë 50,000.00€ ndërsa shumën tjetër do ta subvencionoj Shoqata “Jetimat e Ballkanit”.

Të nderuar asamblistë, kërkojmë nga Ju që ta përkrahni dhe ta votoni këtë propozim vendim.

z.Shaban Bajoku, theksoi, ne si Grup i këshilltarëve të LDK-së e mbështesim në parim këtë propozim vendim pasi që ju sigurohet 10 familjeve çështja e banimit që është një nga nevojat esenciale për të pasur një jetë normale. Kjo iniciativë është vazhdim i marrëveshjes së vitit 2020 që komuna jonë ka pasur me shoqatën “Jetimat e Ballkanit” për ndërtimin e 26 shtëpive të cilat tani janë në përfundim e që shpresoj që për festën e Bajramit të gjithë ata përfitues të festojnë në shtëpitë e tyre të reja. Duke parë rendësin e këtij vendimi ne si grup i këshilltarëve të LDK-së propozojmë që të rritet numri i shtëpive nga 10 në 15 shtëpi dhe shuma nga 50,000.00€ të rritet në 75,000.00€. Shpresojmë shumë që të përkrahet nga të gjitha grupet e Kuvendit Komunal ky propozim. Para se të hidhet në votim ky propozim vendim kërkoj nga të gjithë të deklarohen a e pranoni këtë propozim. Tani çështja e dytë që për ne është e pa qartë është se ku do të merren konkretisht mjetet për realizimin e këtij vendimi. Ne e kemi këtë shqetësim duke u bazuar në propozim vendimi ku thuhet se vendimi zbatohet nga DSHMS-ja dhe DBF. Sa i përket DBF-së është se ajo e bënë ekzekutimin e pagesës, mirëpo dilema jonë është se DSHMS a e ka të planifikuar një buxhet prej 50,000.00€ në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve, mjete këto që janë të dedikuara për ndihmën e familjeve me gjendje të rëndë sociale dhe atyre në gjendje të rëndë shëndetësore me sëmundje të rënda dhe terapi të shtrenjta, kur e kemi këtë parasysh atëherë shtrohet pyetja ku do t’i marrim këto mjete. Ne kërkojmë të specifikohet burimi i mjeteve, drejtoria ku do t’i marrë mjetet në mënyrë që të sigurohet që ky vendim të realizohet.

z.Kasim Bashota, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LVV-së e përkrahim këtë pikë e cila është pa interesa politike dhe e falënderojmë shoqatën “Jetimat e Ballkanit” që e ka sjellë këtë projekt në Podujevë, po ashtu e falënderoj edhe qeverisjen lokale për mbështetjen, besoj që kemi edhe shumë familje në nevojë për tu ndërtuar shtëpi por i përgëzoj këto familje përfituese, propozoj që të gjithë të votojmë këtë pikë sepse mbi të gjitha është humane.

z.Bashkim Sylja, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së jemi pro mbështetjes financiare për ndërtimin e këtyre shtëpive për familje në gjendje të rëndë ekonomike gjithashtu shpresoj që komisioni në pikën e ardhshme të rendit të ditës të plotësohet dhe ta bëjë punën e vet ashtu siç është më së miri dhe të përzgjedh familjet që kanë më së shumti nevojë.

z.Agim Behluli, theksoi, unë personalisht e mbështes këtë projekt edhe pse qenkan vetëm 10 shtëpi e që kisha dashur me qenë më shumë, propozim i imi është që në atë komision me qenë dikush nga asambleja dhe me qenë ma transparent dhe efikas çysh ka qenë komisioni në “Lagjen e Kuvajtit” sepse herën e fundit janë nda shtëpitë pa ndonjë komision por këtë here dua me qenë në komision edhe dikush nga asambleja komunale dhe mundësisht me u rrit ai numër i ndërtimit të shtëpive sepse dihet që ka shumë familje nevojë që se kanë të zgjidhur çështjen e banimit.

z.Benjamin Ejupi, theksoi, në emër të Partisë së Drejtësisë e mbështesim këtë propozim vendim për ndarjen e këtyre mjeteve dhe e falënderojmë shoqatën “Jetimat e Ballkanit”, gjithashtu shpresoj që në të ardhmen të kemi sa më shumë donator dhe të kemi një ulje të këtyre familjeve në nevojë për shtëpi.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, kam një pyetje për drejtorin e DSHMS, kush i përzgjedh këto 10 familje a i përzgjedh Shoqata “Jetimat e Ballkanit” apo Kuvendi Komunal.

z.Driton Veliu, drejtor i DSHMS-së, përgjigje parafolësit, theksoi, është një komision i përbërë prej Shoqatës “Jetimat e Ballkanit” dhe përfaqësuesit e Drejtorisë tonë.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, kërkoj falje sepse erdha me vonesë por vetëm dëshiroj t'ju sqaroj më shumë rreth kësaj pike. Gjatë takimeve që kam pasë me z.Halil Kastratin, fillimisht na është premtuar se do t'na mbështet për ndërtimin e 20 shtëpive, mirëpo duke marrë parasysh gjendjen që ky vite është vite zgjedhor në nivel lokal, në shumicën e Komunave Shoqata “Jetimat e Ballkanit” ka planifikuar të ndërtoj shtëpi banimi, por disa prej tyre i ka anuluar për shkak të mos politizimit të kësaj çështje. z.Halil Kastrati ka deklaruar se premtimi ka qenë që do të realizohet ndërtimi i 20 shtëpive gjatë këtij viti për raste sociale dhe me gjendje të rëndë të banimit në Komunën e Podujevës, mirëpo për shkak të mos politizimit të kësaj çështje, këtë vit do ndërtojmë vetëm 10 shtëpi, projekt në të cilin Komuna e Podujevës do të participoj me 5000.00€ për një shtëpi, kurse komunat tjera kanë participuar 8000.00€ për një shtëpi, kështu që neve na nevojiten 50,000.00€ për ndërtimin e 10 shtëpive.

Sa i përket asaj që u propozua të ndahen më shumë mjete buxhetore për ndërtimin e më shumë shtëpive, mund t'ju sqaroj se nuk kemi marrëveshje të tillë për ndërtimin e më shumë shtëpive. Këtu prezent nuk qenka drejtori i DBF-së të na tregoj se a kemi mjete buxhetore për ndërtimin e shtëpive në bazë të mundësive tona buxhetore. Pra nuk kemi marrëveshje tjetër me Shoqatën “Jetimat e Ballkanit” përveç ndërtimit të këtyre 10 shtëpive, prandaj është mirë që ta respektojmë Marrëveshjen aktuale sipas të cilës nevojitet ndarja e shumës 50,000.00€, ndërsa për shumën tjera buxhetore, në qoftë se e vlerësojmë që kemi buxhet shtesë të mjaftueshëm për ndërtimin e ndonjë shtëpie tjetër, gjithçka është në rregull.

z.Ragip Fetahu, theksoi, në lidhje me atë që ceku z.Agimi Behluli unë e përkrah që ky komision të zgjerohet edhe me ndonjë anëtar të Kuvendit Komunal dhe në këtë komision të bartet ky komisioni që ka qenë për ndarjen e shtëpive në “Lagjen e Kuvajtit” për hir të transparencës së përgjithshme.

z.Driton Veliu, drejtor i DSHMS-së, theksoi, kjo nuk mund të bëhet sepse është marrëveshje tjetër dhe duhet komision i veçantë pasi që shoqata “Jetimat e Ballkanit” e bënë subvencionimin me pagës ata i kanë përcaktuar edhe kushtet e veta paraprakisht dhe komisioni është 2+2, do të thotë 2 përfaqësues nga Komuna dhe 2 nga Shoqata “Jetimat e Ballkanit”, gjithsej katër anëtar, kështu është marrëveshja.

z.Fatmir Gashi Kryesues i Kuvendit, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim propozim vendimin sipas kësaj pike të rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri miratohet propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare - për subvencionimin e bashkëfinancimit të ndërtimit të shtëpive të banimit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike dhe të banimit në Komunën e Podujevës, me Shoqatën Bamirëse “Jetimat e Ballkanit”

8. Propozim vendimi për lirim nga taksa komunale – shfrytëzimi i hapësirave publike / tarracave pran lokaleve të subjekteve afariste të gastronomisë dhe operatorët e transportit publik

z.Fevzi Jetullahu, drejtor DSHPMSh, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, ne si Drejtori e kemi parë të arsyeshme të dal me propozim vendim për lirim nga taksat komunale për shfrytëzimin e hapësirave publike, tarracave pran lokaleve të subjekteve afariste të gastronomisë dhe operatorët e transportit publik që ushtrojnë këto veprimtari në komunën tonë, kështu që pres përkrahje nga ana juaj.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, sa i përket për lirim nga taksa për pjesën e tarracave në sektorin e gastronomisë në si Grup i këshilltarëve të LDK-së e përkrahim këtë propozim. Këtë e kemi bërë si kërkesë edhe në seancën e kaluar për lirim nga një numri më të madh të bizneseve dhe jo vetëm për këtë kategori dhe mendoj se pjesë e kësaj liste duhet të jenë edhe bizneset e pjesës të rruga “Zahir Pajaziti” ku po ndërtohet sheshi pasi që janë shumë të dëmtuara si biznese. Një sqarim për këtë kategorinë e transportit publik nëse ke mundësi me na tregua kush bënë pjesë saktë në këtë kategori drejtor.

z.Florent Hasani, theksoi, në Grupi i asamblistëve të LVV-së e mbështesim propozim vendimin për lirim nga taksa komunale, shfrytëzimi i hapësirave publike, tarracave pran lokaleve të subjekteve afariste të gastronomisë dhe operatorët e transportit publik për arsye të krijuara nga pandemia Covid-19. Kërkojmë nga Drejtoria e Inspeksionit që të vëzhgoj ushtrimin e veprimtarisë në këto tarraca me qëllim që të mos cenohet hapësira e paraparë për këmbësorë.

z.Fatmir Rudari, theksoi, në Grupi i asamblistëve të PDK-së e përkrahim këtë kërkesë pasi që kjo kategori ka qenë më e dëmtuara gjatë pandemisë.

z.Hasan Ajeti, theksoi, është identike edhe pyetja ime sa i për ketë transportit publik, kush bënë pjesë saktë në këtë lirim.

z.Fevzi Jetullahu, drejtor i DSHPMSh, theksoi, unë në mbledhjen e KPF-së e sqarova se do të jetë për të gjithë transportin që nënkupton për të gjithë ata që ushtrojnë këtë veprimtari në Komunën tonë dhe jo vetëm për transportin publik.

z.Hasan Ajeti, theksoi, kam një pyetje për ju drejtor, këtu a kemi të bëjmë me linjat e autobusëve të linjës Podujevë-Prishtinë.

z.Fevzi Jetullahu, drejtor i DSHPMSh, theksoi, drejtoria jonë nuk ka të bëjë me linjat e transportuesve Podujevë-Prishtinë kjo është kompetencë e ministrisë, këtu kemi të bëjmë me lirim nga pagesa për minibusët dhe busët që e ushtrojnë veprimtarinë brenda territorit të Komunës së Podujevës në qytet dhe fshatra.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim propozim vendimin sipas kësaj pike të rendit të ditës.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri miratohet Propozim vendimi për lirim nga taksa komunale - shfrytëzimi i hapësirave publike / tarracave pran lokaleve të subjekteve afariste të gastronomisë dhe operatorët e transportit publik.

9. Plotësim ndryshimi i përbërjes së Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në “Lagjen e Dëshmorëve” në fshatin Balloc, i ngritur me Vendimin nr.prot.01-020/04-0026812/18 të datës 28 mars 2018

z.Driton Veliu, drejtor DSHMS, po ashtu edhe për këtë pike të rendit të ditës e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, në kemi kërkuar që të kompletohet komisioni për shkak të dorëheqjes së asamblistit z.Vendenis Lahu, grupi i asamblistëve të Lëvizjes Vetëvendosje kanë kërkuar ta zëvendësojnë me një anëtar tjetër dhe të bëhet kompletimi i komisionit për vlerësimin e familjeve për strehim në shtëpitë e reja që do të ndërtohen në ditët në vijim, kryetar i komisionit është z.Agim Behluli dhe shpresojmë që grupi i LVV-së e ka caktuar një anëtar për kompletimin e këtij komisionit.

z.Haki Rudari, theksoi, kam qenë katër vite anëtar i këtij komisioni për ndarjen e shtëpive në “Lagjen e Dëshmove” dua të sqaroj se për ndarje është nxjerrë një rregullore në Kuvendin Komunal dhe po ashtu ky komision është i përbërë nga tri grupet më të mëdha politike me nga një përfaqësues, do të thotë nga LVV-ja ka një përfaqësues e që tash do të zëvendësohet z.Vendenis Lahu me kolegun Ragip Fetahu, nga PDK-ja një përfaqësues, nga LDK-ja një, nga shoqatat e luftës duhet të jetë dikush prezent dhe një duhet të jetë nga DSHMS, ish drejtori është këtu dhe ish kryesuesi është këtu, ka qenë edhe një zyrtar nga drejtoria përkatëse në komision. Prandaj, është mirë të bëhen këto dy zëvendësime, një kolegu Ragip Fetahu që e propozuam dhe një nga DSHMS, për tu kompletuar ky komision. Unë e kam edhe rregulloren që është nxjerr nga Kuvendi.

z.Driton Veliu, drejtor DSHMS, theksoi, ne jemi të gatshëm që të propozojmë zyrtarin tonë.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, mos të ngutemi rreth procedurave. Propozimi ka qenë konkret për zëvendësimin e një anëtar, fjala është për zëvendësimin e ish asamblistit z.Vendenis Lahu që tani dihet që ka kaluar në Kuvendin e Kosovës, subjekti përkatës të jap propozimin për plotësimin e këtij komisioni, ndërsa propozimi i z.Rudari ishte për komisionin që ka qenë më parë.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, mendoj që asamblisti parafolës z.Haki Rudari e kishte fjalën për diçka tjetër. Është e vërtetë që ne në rend të ditës e kemi plotësim ndryshimin e përbërjes së komisionit dhe zëvendësimin e asamblistit nga radhët e LVV-së, e që në fakt mungon në këtë komision, mirëpo në komision siç e shihni Grupi i këshilltarëve të LDK-së është i përfaqësuar me dy anëtarë, gjë që përfaqësimi i LDK-së me dy anëtar në këtë komision ia ka mohua të drejtën e përfaqësimit Drejtorisë kompetente me të cilën lidhet çdo gjë që ka të bëjë me këtë problematik. Vendimi në fjalë nuk e di se si është marrë në atë Kuvend, por me këtë vendim është shkelur rregullorja e përfaqësimit brenda këtij komisioni sepse LDK-së, PDK-së dhe LVV-së i ka takuar nga një anëtar prej përbërjes së Kuvendit, anëtar i 4-të është dashur të jetë nga DSHMS-ja, dhe anëtar i 5-të që qenka përfaqësues i organizatave të dala nga lufta e UÇK-së. Meqë është në rend dite kjo pikë, do të ishte mirë që komisionin ta formoni komform rregullores, ashtu siç parashihet përbërja e komisionit. Pra meqenëse u hap kjo temë, nuk ka asgjë të keqe që ta anuloni atë vendim i cili është nxjerrë gabim dhe përbën shkelje të rregullores që duhet ta respektonte ky Kuvend.

Në kuadër të DSHMS-së, unë e propozoj që znj.Arbëresha Bashota të jetë pjesë e komisionit në fjalë pasi që është një zyrtare e cila punon në projektin me “Jetimat e Ballkanit”, në mënyrë që që përbërja e komisionit të jetë në rregull sepse është përjashtuar Drejtoria përkatëse e që duhet domosdoshmërisht të jetë pjesë përbërëse e këtij komisioni.

z.Agim Behluli, theksoi, unë kam qenë kryetar i komisionit dhe është e vërtetë që kemi qenë dy anëtar nga LDK-ja, znj.Arbëresha Bashota ka marrë pjesë çdo herë kur ne jemi ulur rreth vlerësimit të dokumentacionit përveç kësaj kemi ftuar edhe një person nga Ministria e Shëndetësisë dhe jemi munduar me bë më të mirën që është e mundshme. Nga LDK-ja unë kam qenë kryetar i komisionit ku ka qenë edhe znj.Valbona Kadriu - Podvorica, ne mundemi me ndërruar përbërjen e komisionit tash por ai projekt është në fund dhe e shfrytëzoj rastin të bëj thirrje sepse tani në fund po hasim në probleme sepse aty ka njerëz që kanë filluar t’i kërkojnë nga dy shtëpi, kështu që ky komision ka qenë më i njoftuari prej të gjithë juve rreth situatës që është mirëpo nëse ju dëshironi ta ndryshoni përbërjen e komisionit s’ka problem atëherë unë tërhiqem, në këtë përbërje ka qenë edhe përfaqësuesi i LVV-së, puna ka ecë përpara. Ne çdo herë jemi munduar me bë më të mirën andaj propozimi im është që mos të ndryshohet përbërja e këtij komisioni por prapë vendosni ju si të doni.

z.Hasan Ajeti, theksoi, realisht në kohën kur ka qeverisë LDK-ja ne e dimë që çdo hap që del nga ky Kuvend përcillet edhe në Ministrinë respektive, do të thotë për çështjen se a janë shkel apo jo procedurat është Ministria që e jep verdiktin. Ne jemi para një pike që duhet të bëjmë plotësim

ndryshimin për zëvendësimin e z.Vendenis Lahu me z.Ragip Fetahun, nëse doni që propozimi i Kryetarit z.Shpejtim Bulliqi të dal në votim atëherë le të del në votim ai propozim dhe të shohim se a kalon apo jo ky propozim dhe të vazhdojmë përpara. Besoj që qëllimi më shumë është t'ju ndihmojmë atyre familjeve në nevojë se sa të vazhdojmë diskutimin për zëvendësimin e dikujt tjetër.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, nuk dëshiroj të kemi keqkuptime, nuk është qëllimi im të ndërrohet përbërja e komisionit, unë vetëm po tregoj që baza ligjore e atij vendimi nuk është në përputhje me ligjin, ndërsa a e ndërroni apo jo është çështje e juaja si Kuvend, pra nuk dua të insistoj që me çdo kusht ta ndërroni këtë përbërje, por me bazë ligjore jeni keq sepse Ekzekutivi i Komunës ka mbetë pa përfaqësim në komisioni e cekur, dhe jam në dijeni që zyrtarja e DSHMS-së znj.Arbëresha Bashota ka marrë pjesë në atë komision, dhe mirë që ka marrë pjesë sepse ju ka ndihmuar, por asnjë obligim nuk e ka e cekura pa qenë pjesë e atij komisioni ngase është përjashtuar Drejtoria përkatëse nga përfaqësimi në atë komision.

Pra po foli për kohën e njëjtë që vazhdon të jetë e njëjta edhe tani, ndërsa se a e ndërroni apo jo përbërjen e komisionit, është e drejtë e juaja si Kuvend.

z.Hasan Ajeti, theksoi, ky vendim i propozuar në atë kohë e ka një bazë ligjore, dhe në qoftë se thua një gjë të tillë për çdo akt që prodhohet këtu në Kuvend dhe pastaj nesër të dilet me propozim (i drejtohet Kryetarit të Komunës), mund të spekulim, pra ky është një spekulim paragjykses e që është kundërligjor.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, nuk mundemi me thënë që nuk është e përfshimë ose nuk është e obliguar me marrë pjesë përfaqësuesja e drejtorisë kur kemi parasysh që në këtë vendim që ne kemi marrë ky komision ka funksionuar dhe ka bërë punën më të mirë të mundshme, pra në kuadër të këtij vendimi është neni 2 që e thotë qartë se “në cilësinë e vëzhguesit në punën e komisionit marrin pjesë edhe përfaqësues të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale edhe përfaqësues të drejtorisë përkatëse”. Si i tillë ky vendim i ka të gjitha elementet e përfaqësimit.

z.Haki Rudari, theksoi, të nderuar koleg/e unë thash diçka që është në rregullorë e që janë prezent ish drejtori me gjithë respektin, për ish kryesuesin. Ka qenë një komision ku tri partitë e mëdha kanë pasur nga një përfaqësues, shoqatat e luftës një përfaqësues dhe nga drejtorja ka qenë një përfaqësues, nëse nuk është ashtu le ta demantojnë kolegët që janë prezent. Ne po themi që edhe tash partitë e mëdha ta kenë nga një përfaqësues plus përfaqësuesi nga shoqatat e luftës edhe një përfaqësues nga DSHMS, kështu ka qenë rregullorja dhe nuk ka ndryshuar ende.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kemi dy propozime lidhur me këtë çështje, pra kemi propozimin sipas materialit përkatës dhe thirrjes së mbledhjes, dhe propozimin tjetër të Ekzekutivit.

Pra fillimisht e hedh në votim propozimin sipas thirrjes dhe materialit të kësaj pike përfshirë edhe konstatimet nga mbledhja e KPF-së që ka të bëjë me plotësim ndryshimin e komisionit përkatësisht zëvendësimin e z.Vendenis Lahut me këshilltarin z.Ragip Fetahu.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri votohet, plotësim ndryshimi i përbërjes së Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në “Lagjen e Dëshmorëve” në fshatin Balloc, i ngritur me Vendimin nr.prot.01-020/04-0026812/18 të datës 28 mars 2018, dhe atë në vend të ish këshilltarit të Kuvendit dhe anëtarit të Komisionit në fjalë z.Vendenis Lahu, emërohet z.Ragip Fetahu.

10. Marrja e masave për lirimin e pronave me qëllim të implementimit të projektit për ndërtimin e obeliskut “Afrim Zhitia” në fshatin Llugë.

z.Fatmir Gashi Kryesues i Kuvendit, theksoi, kjo pikë e rendit të ditës hyri si pikë shtesë e propozuar nga këshilltari z.Rafet Llapashtica i cili propozoi (nëse e kam mbajtur mend mirë) që të merret vendim sipas të cilit kërkohet lirimi i hapësirave përkatëse në fshatin Llugë, me qëllim të implementimit të projektit për ndërtimin e Obeliskut “Afrim Zhitia”. Ftoj propozuesin ta merr fjalën dhe të prezantoj propozimin në fjalë.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, i nderuar Kryesues, propozimi është ai që e paraqita në fillim të kësaj mbledhje, të hidhet në votim dhe pres që të miratohet.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim propozimin e z.Rafet Llapashtica.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se njëzëri miratohet propozim që të nxjerrët vendim, si në vijim;

-Me këtë vendim kërkohet të ndërmerren masat e nevojshme për lirimin e pjesës së pronës përkatëse në fshatin Llugë – Komuna e Podujevës, me qëllim të implementimit të projektit për ndërtimin e Obeliskut “Afrim Zhitia”

-Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Inspeksionit dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

11. Të ndryshme

znj.Arlinda Kadriu, theksoi, në seancën e kaluar jam zgjedhur anëtare e Komisionit për Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës konkretisht anëtare për dhënien në shfrytëzim të lokalit në qytet në rrugën “Skënderbeu” dhe ju njoftoj që për arsye subjektive më duhet të jap dorëheqje, faleminderit në mirëkuptim.

z.Mehmet Gashi, theksoi, kam dy pyetje meqenëse nuk kaloj si draft Rregullorja për Tarifa, propozoj që për mbledhjen e ardhshme të propozohet një draft për lirimin e të gjitha subjekteve afariste nga kjo taksë sepse të gjitha subjektet e kanë tatimin në qarkullim dhe i kanë obligimet tjera, taksën komunale komunat tjera e kanë heqë prandaj propozoj që taksa komunale për subjektet afariste të lirohen për një periudhë të caktuar për shkak të pandemisë, por jo në formën si ishte më parë me draftin që u refuzua. Pyetja e dytë ka të bëjë me Parkun e Paqes megjithëse Kryetari një ditë e kishte vizituar, mirëpo nuk e di a i kanë evidentuar se ka 3 muaj prej kur ka pas reshje të dëborës i ka shkatërruar pishat dhe parku është në një gjendje jashtëzakonisht të keqe dhe paraqet shumë rrezik për personat që e frekuentojnë atë pjesë nga rënia e ndonjë lisi. Me siguri Kryetari e ka ndërmend të ndërmarrë ndonjë veprim mirëpo desha t’ju përkujtoj që të ndërmarrin masat e nevojshme.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, i respektuari këshilltar i Kuvendit (i drejtohet z.Mehmet Gashit), është shumë e vërtetë se gjendja e atyre drunjëve është e keqe sepse janë dëmtuar shumë nga kushtet atmosferike. Ne dy herë kemi shpallë ankand publik për pastrimin e parkut në fjalë, herën e parë ka dështuar thirrja kurse herën e dytë është caktuar dikush që do ta bëjë pastrimin e parkut. Tani planifikohet pastrimi i gjithë asaj pjesë dhe aty ku kemi hapësira do i mbjellim edhe disa drunjë, pra besoj se do të zgjidhet shpejt kjo çështje.

z.Ragip Fetahu, theksoi, kemi të bëjmë me një palestër sportive ku pronari i saj me 08 janar 2021 pretendon se i është shkatërruar nga rrufeja dhe sipas tij dëmet janë rreth 70,000.00€, ai gjithashtu

thotë se palestra është shfrytëzuar edhe nga shkollat aty afër që janë për qëllime sportive. Ekzekutivi duhet të shqyrtoj mundësitë që t'i dal në ndihmë këtij pronari sepse e ka të pamundur vet ta funksionalizoj prapë këtë palestër e cila është në dobi edhe të komunitetit që jeton aty. Çështja e dytë të cilën dua ta ngrisë është çështja e tregut të ri, ky treg është ndërtuar para pak vitesh gjendja e tij është e tmerrshme, në qoftë se dalim dhe shohim pak më lartë është sikur një treg në Kandahar dhe është mirë që ekzekutivi të shqyrtoj modalitete që këtë treg ta marrë përsipër ta mirëmbaj dhe ta menaxhoj. Unë nuk di që një pronë publike mirëmbahet dhe menaxhohet nga persona privat, ajo është një pronë publike dhe duhet të mirëmbahet dhe menaxhohet nga Komuna, janë dy roje që i shohë që flenë në një veturë të tipit Wolsfagen Golf II dhe paguhen prej atyre me nga 50 €, është mirë që të shikohen mundësitë buxhetore dhe të bëhen modalitete dhe të formohet një ndërmarrje publike nga Komuna jo vetëm për këtë pronë por të gjitha pronat publike që të mirëmbahen dhe menaxhohen më mirë.

z.Agim Behluli, theksoi, kam një propozim por që nuk qenka prezent drejtori i DBF-së, pasi që kemi filluar me i financua të afërmit e Komunës për raste të vdekjes është mirë edhe të afërmit e personave që kanë vdekur nga virusi Covid-19, me ju ndihmua nga pak, pasi që nuk kemi pas mundësi buxhetore t'i ndihmojmë personat e infektuar me virusin Covid-19, së paku do të ishte mirë që t'ju ndihmojmë atyre familjeve që kanë humbur familjarët e tyre nga ky virus.

z.Hasan Ajeti, theksoi, pyetja ime ka të bëjë me vendosjen e lojërave që janë tek xhamia “Met Podjeva” dhe këtyre në qendër kur dihet që është kohë pandemie, pyes ekzekutivin a kanë leje këto kompani në fjalë për vendosjen e këtyre lojërave.

z.Fevzi Jetullahu, drejtor i DSHPMSh, theksoi, tek Xhamia “Met Podjeva” për vendosjen e lojërave ju është dhënë leja gjithëherë komfor masave dhe rekomandimeve të institutit të shëndetit publik, ndërsa për momentin janë të ndaluar nga inspeksioni vendosja e lojërave tjetra sepse nuk kanë marrë leje.

z.Driton Veliu, drejtor i DSHMS-së, theksoi, kur është fjala për numrin e vdekjeve, nga virusi Covid-19, në Komunën e Podujevës deri tani i kemi 59 raste të vdekjes, ndërsa i kemi 4056 raste të infektuar dhe 288 raste janë aktive.

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, sa i përket propozimit të këshilltarit z.Agim Behluli mendoj që është shumë me vend, mund ta përgatitni një propozim në seancën e radhës nëse e vlerësoni Ju në bashkëpunim edhe me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe ta caktoni një shumë buxhetore që është e përbalueshme nga Ekzekutivi i Komunës.

Pajtohem plotësisht që të paktën t'iu ndihmohet familjeve që kanë pësuar tragjikisht (me vdekje të anëtarëve të tyre) nga covid-19 në këtë pandemi, pra të ndihmohen me një shumë financiare, sa do që të jetë ajo shumë nga ana ime është në rregull gjithçka, vetëm kërkoj t'i harmonizoni qëndrimet dhe të draftohet propozimi dhe ta procedojmë si pikë të rendit të ditës në mbledhjen e radhës, e shqyrtojmë, e caktojmë shumën, e votojmë dhe vazhdojmë tutje.

Meqë nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 14:20
Procesverbalin e mbajti
Osman Bajrami

Nr.01-060/04-0035807/21
Podujevë,
29 prill 2021

Kryesuesi i Kuvendit
Fatmir Gashi